# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5789
E mërkurë, 29 maj 2019
çmimi 0.40 €


## Thaçi: Roli i ShBA-së në dialog, i pazëvendësueshëm

FAQE 7




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", SHAQIR TOTAJ FAQE 4-5



# Qeverisja në Prizren nuk ka treguar nivelin që kanë pritur qytetarët

Kryetari i ri i Degës së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Prizren, Shaqir Totaj, e ka vlerësuar të suksesshëm procesin e brendshëm zgjedhor në këtë parti. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se ky proces e ka fuqizuar këtë subjekt politik. Sipas Totajt, zgjedhjet e brendshme kanë ndikuar që të bëhet një ripërtëritje e resurseve në degët dhe strukturat e tjera të PDK-së. Ai është shprehur i bindur se rezultati i zgjedhjeve të reja kombëtare do të jetë në favor të PDK-së. Ai e ka kritikuar qeverisjen lokale në Prizren duke thënë se ajo është një shembull tipik i keqpërdorimit të besimit të dhënë nga qytetarët. Sipas Totajt, qeverisja komunale në Prizren as përafërsisht nuk është treguar në nivel të pritjeve të qytetarëve

## OPINION

### E PSE JO NJË SHTET? F.11



Nga Ismet HAJRULLAHU

## AKTUALE

### IKD-ja: Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial sfidohen nga joefikasiteti... F. 5

## EKONOMI

### Reçica: Rritja e punësueshmërisë kërkon reforma ligjore dhe modernizim të shërbimeve të punësimit F. 8

### Haradinaj: Qeveria, e pakompromis në luftën kundër informalitetit F. 9

# Aksioni në veri sjell në pranga 19 zyrtarë policorë FAQE 3



Nën dyshimin për kryerje të veprave penale, nëntëmbëdhjetë zyrtarë policorë janë arrestuar të martën gjatë një aksioni policor në veri. Njëmbëdhjetë prej të arrestuarve janë serbë, katër shqiptarë dhe katër boshnjakë. Ata dyshohen për pjesëmarrje ose organizim të grupit kriminal, kontrabandim të mallrave, keqpërdorim të pozitës zyrtare, dhënie të ryshfetit dhe tregti e ndaluar. Gjatë realizimit të këtij aksioni policia ka hasur në rezistencë të armatosur në hyrje të Zubin Potokut, me ç'rast dy policë janë plagosur dhe tre të tjerë janë lënduar duke larguar barrikadat

## KULTURË

### Florentina Ferati (Tina) nga Ferizaj, inxhiniere e sigurisë kibernetike në 'Facebook' F. 11





# Mësimdhënësit e viteve të '90-ta i presin pensionet e para pas qershorit FAQE 2

## SPORT

### Selimi: Jam nismëtar i sukseseve të Feronikelit F. 24




RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Kuvendi i Serbisë miraton raportin për Kosovën



**Beograd, 28 maj** - Kuvendi i Serbisë ka miratuar raportin për Kosovën të cilin e ka përpiluar zyra për Kosovën në Qeverinë e Serbisë. Raporti u miratua me 145 vota për, katër kundër, ndërkaq 13 deputetë nuk kanë votuar. Një pjesë e opozitës serbe nuk ka marrë pjesë në punimet e Kuvendit.
Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, gjatë diskutimeve dyditore të raportit në Kuvendin e Serbisë, ka thënë se "Serbia duhet ta pranojë se e ka humbur kontrollin mbi Kosovën dhe se duhet të gjejë kompromis me Prishtinën për t'i normalizuar raportet".
Deputetët kanë diskutuar për raportin që ka 82 faqe dhe në të cilin në 17 faqe paraqiten të dhënat mbi dialogun ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës nga viti 2013 deri në maj 2019, ndërsa pjesa tjetër paraqet rezultatet më të rëndësishme të Zyrës për Kosovën nga maji 2014 deri në vitin 2019.
Në raport thuhet se dialogu në çdo drejtim ka punuar për interesat e serbëve si dhe gjatë periudhës së bisedimeve është arritur të ruhet qetësia në Kosovë dhe më gjerë.

# Lufta për pozitat kryesore në Bashkimin Evropian

Mbështetja e kancelares Merkel për deputetin gjerman Manfred Weber, i cili udhëheq Partinë Popullore Evropiane, për zëvendësimin e Jean-Claude Junckerit në postin e presidentit të Komisionit Evropian, po has në rezistencë nga presidenti i Francës, Emmanuel Macron



**Bruksel, 28 maj** - Parisi dhe Berlini duket se janë në mosmarrëveshje për zëvendësimin e Jean-Claude Junckerit në postin e presidentit të Komisionit Evropian, pasi rezultatet e dobëta të partive të qendrës në zgjedhjet për Parlamentin Evropian e dëmtuan të zgjedhurin e kancelares gjermane Angela Merkel.
Mbështetja e Merkelit për deputetin gjerman Manfred Weber, i cili udhëheq Partinë Popullore Evropiane, po has në rezistencë nga presidenti i Francës, Emmanuel Macron, ka njoftuar rfe. Krerët e shteteve dhe të qeverive të Bashkimit Evropian janë takuar të martën mbrëma për të diskutuar rreth udhëheqjes së institucioneve të bllokut.
Partia Popullore Evropiane mbetet më e madhja në Parlamentin Evropian, por ajo u dobësua nga 221 ulëse sa ka fituar në zgjedhjet e vitit 2014 në 180 ulëse në zgjedhjet që u zhvilluan nga data 23 deri më 26 maj.
Grupi i Socialistëve dhe i Demokratëve po ashtu ra nga 191 ulëse, pesë vjet më parë, në 145 ulëse sivjet. Kjo është hera e parë në 40 vjet që dy grupet nuk mund të formojnë një shumicë të qëndrueshme që do t'u mundësonte atyre të vendosin për pozitat kryesore dhe agjendën legjislative.
Zgjedhja e shteteve anëtare për presidentin e Komisionit Evropian kërkon miratimin e shumicës në Parlamentin Evropian. Fitues të mëdhenj në zgjedhjet e javës së kaluar ishin Të Gjelbrit, që u rritën nga 50 në 69 ulëse, dhe Aleanca e Liberalëve dhe Demokratëve me 109 ulëse, nga 67. "Për të bërë një shumicë të qëndrueshme në këtë parlament, Të Gjelbrit tani janë të domosdoshëm", tha bashkëkryesuesi i Të Gjelbërve, Philippe Lamberts, deputet belg.
Partia Popullore Evropiane, megjithatë, mbetet grupi më i madh në Parlamentin Evropian.
Annegret Kramp-Karrenbauer, kryetare e Unionit Demokristian të Merkelit, i cili po ashtu bën pjesë në Partinë Popullore Evropiane, tha se Weber është kandidati kryesor për presidentin e Komisionit Evropian. Sipas të ashtuquajturit Sistem Spitzenkandidat, i cili është përdorur për të emëruar Junckerin në vitin 2014, kandidati i partisë më të madhe pritet ta marrë postin më të lartë të Komisionit. Por, Macron ka thënë se nuk do t'i përmbahet këtij sistemi. Ai zhvilloi bisedime me kryeministrin e Spanjës, Pedro Sanchez, në përpjekje për, siç u tha, formimin e një "aleance përparimtare".
Socialistët e Sanchezit dolën të parët në zgjedhjet evropiane.
Në një deklaratë të përbashkët, partia e Macronit La Rem dhe Aleanca e Liberalëve dhe Demokratëve thanë se "do të jenë të hapura për t'i shqyrtuar të gjithë kandidatët që mund ta mbledhin mbështetjen e familjeve politike".
Një zëdhënës i qeverisë franceze tha se Franca do t'i bashkohet një grupi që do të jetë "motor i një aleance përparimtare". "Pse jo me Të Gjelbrit", pyeti ai.
Sekretari i përgjithshëm i Komisionit Evropian, Martin Selmayr, tha se nuk ka arsye që grupet kryesore politike të mos e ndjekin Sistemin Spitzenkandidat.
Rivalët e Weberit përfshijnë kandidatin e qendrës së majtë, Frans Timmermans, nga Holanda, dhe kandidaten liberale, Margrethe Vestager, nga Danimarka.
Për shkak të ndikimit të ri të Liberalëve dhe të të Gjelbërve, Vestager, e njohur për betejat ligjore me gjigantët e teknologjisë amerikane, mund të shihet si një kandidate kompromisi.
Zyrtarët e tjerë të lartë të BE-së që do të zëvendësohen këtë vit janë: presidenti i Këshillit Evropian, Donald Tusk, presidenti i Bankës Qendrore Evropiane, Mario Draghi, dhe përfaqësuesja e lartë e BE-së për Punë të Jashtme, Federica Mogherini.
Zyrtarët e rinj të lartë do të marrin postet e tyre më 1 nëntor, me përjashtim të shefit të ri të Këshillit Evropian, i cili fillon më 1 dhjetor.
Zgjedhjet e javës së kaluar për Parlamentin Evropian kanë tërhequr vëmendjen edhe për fitoret e disa partive të ekstremit të djathtë, përfshirë Frontin Kombëtar të Marine Le Penit në Francë dhe të Ligës në Itali, të udhëhequr nga ministri i Brendshëm i këtij vendi, Matteo Salvini.

## Basha: Kurrë më pazar me të keqen




**Tiranë, 28 maj** - Takimi me delegacionin e Kongresit Amerikan duket se nuk e ka zbutur aspak liderin e demokratëve Lulzim Basha, pasi fjalimi i tij gjatë një takimi para protestës së 2 qershorit në Elbasan ka qenë i mbushur me mesazhe të forta në drejtim të Edi Ramës. Duke përplasur duart mbi tavolinë, Basha u zotua si kryetar i PD-së dhe opozitës së bashkuar se "s'do të ketë kurrë pazar me të keqen dhe beteja për Shqipërinë si e gjithë Evropa do të shkojë deri në fund, deri në fitore".
Kreu i PD-së hodhi poshtë mundësinë e një marrëveshje të re me Edi Ramën dhe zbuloi se tezat e hedhur së fundmi për qeveri të përbashkët PD-PS janë lëvizje të minjve të frikësuar nga populli. "Njësoj si minjtë të zënë në çark, Edi Rama dhe të tijtë kanë nisur të lëvrijnë. Tani kanë shpërndarë thashetheme, mbase i keni dëgjuar. Minjtë e ndiejnë frikën, ndaj kanë nisur të përhapin formula për zgjidhjen e krizës. Flasin për qeveri të përbashkët Basha-Rama dhe të tjera broçkulla si kjo. Le t'ua kujtojmë të gjithëve se betejën s'e nisëm për karriget tona, as për pushtet në tavolinë, por për shqiptarët dhe votën e lirë e të ndershme", deklaroi Basha.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Policia e Kosovës ka zhvilluar një aksion policor në veri që ka pasur për qëllim luftimin e krimit dhe kontrabandës

# Aksioni në veri sjell në pranga 19 zyrtarë policorë

**Nën dyshimin për kryerje të veprave penale, nëntëmbëdhjetë zyrtarë policorë janë arrestuar të martën gjatë një aksioni policor në veri. Njëmbëdhjetë prej të arrestuarve janë serbë, katër shqiptarë dhe katër boshnjakë. Ata dyshohen për pjesëmarrje ose organizim të grupit kriminal, kontrabandim të mallrave, keqpërdorim të pozitës zyrtare, dhënie të ryshfetit dhe tregti e ndaluar. Gjatë realizimit të këtij aksioni policia ka hasur në rezistencë të armatosur në hyrje të Zubin Potokut, me ç'rast dy policë janë plagosur dhe tre të tjerë janë lënduar duke larguar barrikadat**




EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 28 MAJ - Policia e Kosovës mëngjesin e së martës ka zhvilluar një operacion në veri të vendit i cili ka rezultuar me arrestimin e nëntëmbëdhjetë zyrtarëve policorë të dyshuar për përfshirje në veprat penale: pjesëmarrje ose organizim i grupit kriminal, kontrabandim i mallrave, keqpërdorim i pozitës zyrtare, dhënie e ryshfetit dhe tregti e ndaluar.
Njëmbëdhjetë prej të arrestuarve janë serbë, katër shqiptarë dhe katër boshnjakë.
Gjatë realizimit të këtij operacioni policia ka hasur në rezistencë të armatosur në hyrje të Zubin Potokut, ku grupe të armatosura kanë vendosur barrikada për t'i bllokuar rrugët. Këto grupe kanë sulmuar policinë, me ç'rast një polic është plagosur me armë zjarri, një është lënduar nga një predhë, kurse tre të tjerë kanë pësuar lëndime gjatë përpjekjeve për largimin e barrikadave.
Po ashtu, në barrikada kanë pësuar lëndime të lehta edhe gjashtë qytetarë.
Drejtuesit e institucioneve të rendit në një konferencë për medie kanë bërë me dije se aksioni policor i realizuar në veri ka pasur për qëllim luftimin e krimit dhe kontrabandës.
Prokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK), Sylë Hoxha, ka treguar se për realizimin e këtij aksioni është punuar për më shumë se një vit. Pavarësisht prej vështirësive, ai ka thënë se organet e rendit kanë kryer me profesionalizëm punën e tyre. "Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me hetuesit e Inspektoratit Policor të Kosovës dhe hetuesit e Policisë së Kosovës, ka kryer shumë veprime procedurale qysh nga prilli i vitit të kaluar ndaj disa personave të dyshuar për keqpërdorim të pozitës zyrtare, për krim të organizuar, për kontrabandim të mallit, si dhe për marrje dhe dhënie ryshfeti. Po gjatë kësaj periudhe kemi dëgjuar edhe disa dëshmitarë të cilët kanë kontribuar në mbledhjen e fakteve për veprat e dyshuara penale. Prandaj, pas aktivitetit njëvjeçar, PSRP ka parashtruar kërkesë në Gjykatën Themelore në Prishtinë për kontrollin e shtëpive dhe lokaleve për të gjithë këta të dyshuar. Është bërë një punë e madhe dhe profesionale. Ju e dini se si është gjendja në terren në veri të vendit, kështu që ka pasur vështirësi edhe rreth komunikimit dhe lëvizjes. Por, falë angazhimit dhe punës profesionale detyra është kryer me sukses", ka deklaruar Hoxha.
Kryeshefja ekzekutive e Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK), Miradije Kelmendi, ka thënë se, përveç arrestimit të nëntëmbëdhjetë zyrtarëve policorë, janë bastisur dymbëdhjetë lokacione si dhe janë konfiskuar disa armë, një sasi e parave dhe pajisje teknologjike të cilat do të shërbejnë si prova materiale. Ajo ka treguar se zyrtarët policorë të arrestuar janë suspenduar nga pozitat zyrtare. "Në aksionin e së martës janë bastisur 12 lokacione, janë arrestuar 19 punonjës të Policisë së Kosovës, prej tyre 11 serbë, 4 shqiptarë dhe 4 boshnjakë. Prej policëve të arrestuar një ka qenë në gradën e kapitenit komandant stacioni, tre në gradën e rreshterit dhe të tjerët zyrtarë policorë. Zyrtarëve të arrestuar me urdhër të prokurorit u është caktuar masa e ndalimit për 48 orë. Po ashtu, zyrtarët e arrestuar janë suspenduar nga detyra. Hetimet për këtë rast do të vazhdojnë", është shprehur Kelmendi.
Ndërsa drejtorit i përgjithshëm i Policisë së Kosovës (PK), Rashit Qalaj, ka thënë se operacioni në veri është kryer me sukses dhe me pak pasoja. Ai ka thënë se ka pasur një bashkëpunim shumë të mirë në mes të institucioneve të rendit. "Ka qenë përgatitje e shpejtë, por e planifikuar në detaje që operacioni të realizohet në mënyrë efektive dhe sa me ma pak pasoja. Operacioni ka filluar në orën gjashtë të mëngjesit dhe në shumicën prej komunave ku i kemi pasur të dyshuarit, qoftë qytetarë apo zyrtarë policorë, operacioni ka rrjedhur pa pengesa dhe probleme", ka deklaruar ai, duke shtuar se në Zubin Potok policia ka hasur në rezistencë të armatosur. "Por probleme kemi pasur në Zubin Potok meqë policia ka hasur në një prit nga një gjuajtje me armë, me ç'rast është plagosur një polic i cili, për fat të mirë, ka marrë plagë të lehta, një tjetër është lënduar nga predha dhe tre të tjerë kanë pësuar lëndime gjatë përpjekjes për largimin e barrikadave. Po ashtu, sipas informatave që kemi, në barrikada kanë pësuar lëndime edhe gjashtë qytetarë. Në njërën prej barrikadave ka qenë e pranishme një veturë e UNMIK-ut në të cilën ka qenë një zyrtar rus dhe një zyrtar lokal që punojnë për UNMIK-un. Arsyeja e shoqërimit të tyre në polici ka qenë pjesëmarrja në barrikada. Por, përkundër rezistencës aktive të një pjese të qytetarëve në Zubin Potok, operacioni është zhvilluar me sukses", është shprehur ai.
Qalaj ka thënë se edhe në të ardhmen, kurdo që të ketë nevojë, Policia e Kosovës do ta kryejë me sukses punën e saj. Aksioni policor në veri që ka pasur për qëllim luftimin e krimit dhe kontrabandës është përshëndetur nga drejtuesit e shtetit dhe partitë politike. Lidhur me këtë aksion ka pasur reagime nga Serbia e cila ka bërë përpjekje për ta politizuar operacionin e Policisë së Kosovës në veri.







## Veseli viziton policët e plagosur në krye të detyrës gjatë operacionit në veri

PRISHTINË, 28 MAJ - Kryeparlamentari Kadri Veseli ka vizituar të martën policët e plagosur në krye të detyrës gjatë operacionit në veri. Ai i ka falënderuar policët për punën që bëjnë për sundimin e ligjit në shtetin tonë. Sipas Veselit, të gjithë do të jenë të barabartë para ligjit. "Takova policët e plagosur në krye të detyrës gjatë operacionit të sotshëm dhe i përgëzova për trimërinë dhe profesionalizmin që kanë dëshmuar. U gëzova që lëndimet i kishin të lehta dhe i falënderova për punën që bëjnë për sundimin e ligjit në shtetin tonë. Duke iu uruar shërim të shpejtë, theksova se as uniforma dhe as posti zyrtar nuk ka për ta mbrojtur asnjë kriminel nga forca e ligjit. Të gjithë të barabartë para ligjit!", ka thënë Veseli pas takimit.



Flet për "Epokën e re", Shaqir Totaj

# Qeverisja në Prizren nuk ka treguar



Kryetari i ri i Degës së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Prizren, Shaqir Totaj, e ka vlerësuar të suksesshëm procesin e brendshëm zgjedhor në këtë parti. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se ky proces e ka fuqizuar këtë subjekt politik. Sipas Totajt, zgjedhjet e brendshme kanë ndikuar që të bëhet një ripërtëritje e resurseve në degët dhe strukturat e tjera të PDK-së. Ai është shprehur i bindur se rezultati i zgjedhjeve të reja nacionale do të jetë në favor të PDK-së. Ai e ka kritikuar qeverisjen lokale në Prizren, duke thënë se ajo është një shembull tipik i keqpërdorimit të besimit të dhënë nga qytetarët. Sipas Totajt, qeverisja komunale në Prizren as përafërsisht nuk është treguar në nivel të pritjeve të qytetarëve

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 28 MAJ - Kryetari i ri i Degës së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Prizren, Shaqir Totaj, beson se zgjedhjet e brendshme e kanë fuqizuar këtë subjekt politik. Ai ka deklaruar se ky proces ka ndikuar që të bëhet një ripërtëritje e resurseve në degët dhe strukturat e tjera të PDK-së. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai është shprehur i bindur se rezultati i zgjedhjeve të reja nacionale do të jetë në favor të këtij subjekti politik. "Unë besoj se ka indikatorë relevantë për të krijuar një besim të bazuar të performancës dhe rrjedhimisht rezultati i zgjedhjeve të ardhshme nuk do të jetë i disfavorshëm për PDK-në. Një nga këta indikator është fakti se procesi i brendshëm zgjedhor ka qenë i suksesshëm", ka thënë Totaj.

Ai ka vlerësuar se procesi i zgjedhjeve të brendshme në PDK ka qenë një proces gjithëpërfshirës dhe transparent. "Po ashtu, kemi edhe ndryshim në postin e kryetarit të Degës në Prizren. Vlen të përmendet fakti se tashmë dy ministra të qeverisë aktuale janë zgjedhur kryetarë të degëve në qytetet prej nga vijnë, që mendoj se këto janë argumente për ta përkrahur konceptin e Dekadës së Re, koncept ky i cili me arsye pritet se do të kontribuojë në procesin e mëtutjeshëm të fuqizimit të PDK-së, proces ky i cili tashmë ka filluar", është shprehur Totaj.

I pari i PDK-së në Prizren ka treguar se vetëm në këtë degë kanë marrë pjesë në proces mbi 9 000 anëtarë të grupmoshave dhe të profesioneve të ndryshme. Totaj ka treguar edhe për qëllimet e takimeve që tani po zhvillon me strukturat e reja të partisë. "Qëllimi i këtyre takimeve është të kontribuojmë në ngritjen e cilësisë së relacioneve të brendshme mes strukturave të Degës së PDK-së në Prizren, si parakusht i rëndësishëm drejt ngritjes së cilësisë së aktiviteteve dhe angazhimeve tona", është shprehur ai.

Totaj ka kritikuar qeverisjen aktuale në Prizren, e cila udhëhiqet nga Lëvizja Vetëvendosje. Sipas tij, qeverisja komunale në këtë komunë as përafërsisht nuk është treguar në nivel të pritjeve të qytetarëve. "Kur e them këtë kam parasysh faktin e mungesës së performancës në shumë sektorë, ndër të cilët kisha veçuar: rininë, kulturën dhe sportin, arsimin, prokurimin, menaxhimin e resurseve humane si dhe sektorë të tjerë. Është një shembull tipik i keqpërdorimit të besimit të dhënë nga qytetarët të cilët kanë pritur ndryshime dhe ndryshimet kanë ndodhur, por jo për të mirë", ka thënë Totaj.

**"Epoka e re":** *Z. Totaj, që një kohë jeni zgjedhur në krye të Degës së PDK-së në Prizren. Si ju ka pritur elektorati i PDK-së dhe cilat janë aktivitetet që keni ndërmarrë prej zgjedhjes suaj?*

**Totaj:** Si finalizim i një procesi transparent dhe korrekt të zgjedhjeve të brendshme në Degën e PDK-së në Prizren e kemi pasur kuvendin e degës, ku unë jam zgjedhur kryetar i Degës së PDK-së në Prizren. Elektorati i PDK-së, i cili edhe më ka zgjedhur, më ka pritur me entuziazëm dhe ky fakt tek unë ndikon si burim i energjisë për t'u marrë me sfidat që na presin në të ardhmen. Unë tashmë kam filluar takimet me pjesë integrale të strukturës së degës. Kemi realizuar takime me grupin e asamblistëve, me kryetarët e nëndegëve, me kryesinë e rinisë demokratike dhe me kryesinë e gruas demokratike. E kemi krijuar një orar të takimeve me kryetarin dhe kryesinë e çdo nëndege, ku deri më tani janë mbajtur tetë takime me nëndegë të ndryshme dhe të tjerat do të realizohen tërësisht deri në pjesën e parë të korrikut.

**"Epoka e re":** *Cili është qëllimi i këtyre takimeve?*

**Totaj:** Qëllimi i këtyre takimeve është të kontribuojmë në ngritjen e cilësisë së relacioneve të brendshme mes strukturave të Degës së PDK-së në Prizren si parakusht i rëndësishëm drejt

# nivelin që kanë pritur qytetarët



ngritjes së cilësisë së aktiviteteve dhe angazhimeve tona.

**"Epoka e re":** *Zgjedhjet e brendshme në PDK po shkojnë drejt përfundimit. Sa besoni se e ka fuqizuar PDK-në ky proces?*
**Totaj:** Procesi i zgjedhjeve të brendshme në PDK ka qenë një proces gjithëpërfshirës dhe transparent. Gjatë kohëzgjatjes së këtij procesi vetëm në Degën e Prizrenit kanë marrë pjesë mbi 9 000 anëtarë të grupmoshave dhe të profesioneve të ndryshme. Mendoj se ky proces ka ndikuar që të bëhet një ripërtëritje e resurseve në poste në pjesë të ndryshme të strukturës së degës. Kur e them këtë e kam parasysh se një numër i madh i kryetarëve të nëndegëve janë persona që me parë nuk kanë qenë në këto poste. Po ashtu, kemi edhe ndryshim në postin e kryetarit të Degës në Prizren. Vlen të përmendet fakti se tashmë dy ministra të qeverisë aktuale janë zgjedhur kryetarë të degëve në qytetet prej nga vijnë, që mendoj se këto janë argumente për ta përkrahur konceptin e Dekadës se Re, koncept ky i cili me arsye pritet se do të kontribuojë në procesin e mëtutjeshëm të fuqizimit të PDK-së, proces ky i cili tashmë ka filluar.

**"Epoka e re":** *Disa sondazhe nuk e nxjerrin mirë PDK-në si parti. Sa besoni se në zgjedhjet e ardhshme kjo parti do t'i përmbysë këto mesazhe?*
**Totaj:** Sondazhet gjithmonë duhen marrë seriozisht, pavarësisht se në çaste të caktuara mund të mos jemi të kënaqur me rezultatet që i prezantojnë, sepse ato na tregojnë ku mund të jenë fushat tona për përmirësim. Unë besoj se ka indikatorë relevantë për të krijuar një besim të bazuar të performancës dhe rrjedhimisht rezultati i zgjedhjeve të ardhshme nuk do të jetë i disfavorshëm për PDK-në. Një nga këta indikator është fakti se procesi i brendshëm zgjedhor ka qenë i suksesshëm.

**"Epoka e re":** *Cili është vlerësimi juaj për qeverisjen komunale në Prizren?*
**Totaj:** Mendoj se qeverisja komunale në Prizren as përafërsisht nuk është treguar në nivel të pritjeve të qytetarëve. Kur e them këtë kam parasysh faktin e mungesës së performancës në shumë sektorë, ndër të cilët i kisha veçuar: rininë, kulturën dhe sportin, arsimin, prokurimin, menaxhimin e resurseve humane si dhe sektorë të tjerë. Është një shembull tipik i keqpërdorimit të besimit të dhënë nga qytetarët të cilët kanë pritur ndryshime, dhe ndryshimet kanë ndodhur, por jo për të mirë. Nuk më gëzon fakti se është kështu, sepse kualiteti i jetës në qytetin e Prizrenit nuk po ngritët, por pikërisht për këtë arsye nuk mund të mos i evidentoj lëshimet e shumta të cilat po ndodhin. Ky është një argument se koalicioni qeverisës, sidomos LV-ja, nuk ka vizion për ngritje të kualitetit të jetës institucionale dhe se nuk shquhet për qasje konstruktive, proaktive dhe energji pozitive për të cilën gjë më së shumti kemi nevojë tani.

**"Epoka e re":** *Meqenëse ju vazhdimisht e kritikoni qeverisjen në këtë komunë, a do të thotë kjo që ju sërish do të garoni për të parin e Prizrenit?*
**Totaj:** Mendoj se PDK-ja në zgjedhjet e ardhshme lokale në Prizren, kurdo që të mbahen ato, do të dalë me një ofertë serioze për qytetarët e Prizrenit dhe do të jetë e përfaqësuar denjësisht, pavarësisht se kush do të jetë kandidati.

# IKD-ja: Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial sfidohen nga joefikasiteti, mungesa e llogaridhënies dhe integriteti i kontestuar

PRISHTINË, 28 MAJ (ER) - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), me përkrahje të Departamentit të Shtetit Amerikan - Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtarë dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) dhe NED, të martën ka mbajtur konferencë për media, në të cilën ka publikuar raportin "Pavarësia, efikasiteti, llogaridhënia dhe integriteti i këshillave: Raport i monitorimit sistematik të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial - (Janar-mars 2019)". Gzim Shala, hulumtues në IKD, ka prezantuar gjetjet e raportit, të cilat, sipas IKD-së, dëshmojnë se Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) edhe gjatë tremujorit të parë të vitit 2019 janë përballur me mungesë efikasiteti, llogaridhënie dhe integritet në ushtrimin e përgjegjësive kushtetuese dhe ligjore. Shala ka thënë se si rezultat i monitorimit sistematik që ua bënë dy këshillave, IKD-ja vlerëson se këto institucione, kompetencat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me Kushtetutë dhe ligj, nuk kanë qenë në gjendje që t'i zbatojnë në praktikë. "Është koha e fundit që KGjK dhe KPK ta përmbushin mandatin e vet kushtetues dhe ligjor, në mënyrë që të kemi një sistem gjyqësor më të pavarur, të paanshëm dhe profesional", ka thënë Shala.
Ai ka theksuar se IKD-ja ka monitoruar edhe procesin për funksionalizimin e Departamentit Special në Gjykatën Themelore të Prishtinës, i cili është përshkuar me mungesë të transparencës. "Afati i fundit për funksionalizimin e këtij departamenti është data 2 qershor 2019. Ky departament është jashtëzakonisht i rëndësishëm për shkak se do t'i gjykojë rastet më të mëdha në vend. Për këtë arsye, publiku është i interesuar të dijë se si është duke u zhvilluar ky proces dhe kush do të jenë ata gjyqtarë që do t'i gjykojnë rastet më të rënda në sistemin e drejtësisë së Republikës së Kosovës", është shprehur Shala. Sipas tij, tremujori i parë i vitit 2019, sikurse edhe periudhat e mëhershme, nuk ka shënuar përparim në drejtim të shtimit të efikasitetit të mekanizmave të kontrollit të punës së gjykatësve dhe prokurorëve.



Po ashtu, është theksuar se, në anën tjetër, gjatë kësaj periudhe kohore janë shënuar shumë raste kur gjykatës, prokurorë, kryetarë të gjykatave dhe kryeprokurorë të caktuar kanë rënë në kundërshtim me parimet dhe Kodin e Etikës, por asnjë prej tyre nuk është shkarkuar për shkak të performancës së dobët apo për shkak të masave disiplinore. Nga monitorimi sistematik, IKD-ja ka gjetur se mungon debati në mes të anëtarëve të KGJK-së dhe KPK-së, sidomos debati dhe kontributi përmbajtjesor i tyre gjatë takimeve ku trajtohen politikat, strategjitë dhe dokumentet relevante për miratim.

# Kosova dhe Suedia diskutojnë për reformat kryesore të zhvillimit

Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka thënë se qëllimi kryesor i bashkëpunimit për reformën në mes të Kosovës dhe Suedisë është lehtësimi i rrugës së Kosovës drejt integrimit në BE, duke u përqendruar në zhvillimin ekonomik, zhvillimin e sektorit privat, demokracinë dhe të drejtat e njeriut, si dhe mjedisin dhe ndryshimet klimatike



EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 28 MAJ - Ministria e Integrimit Evropian dhe Ambasada e Suedisë në Kosovë kanë organizuar takimin vjetor midis Suedisë dhe Kosovës në kuadër të bashkëpunimit suedez për reforma në Kosovë si pjesë e marrëveshjes së bashkëpunimit për reforma gjatë viteve 2014-2020.
Në hapje të këtij takimi, ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka thënë se qëllimi kryesor i bashkëpunimit për reformën në mes të Kosovës dhe Suedisë është lehtësimi i rrugës së Kosovës drejt integrimit në BE duke u përqendruar në zhvillimin ekonomik, zhvillimin e sektorit privat, demokracinë dhe të drejtat e njeriut, si dhe mjedisin dhe ndryshimet klimatike.
Ajo ka theksuar rëndësinë e koordinimit të donatorëve përmes grupeve punuese sektoriale dhe ato nënsektoriale dhe Forumit të Nivelit të Lartë. "Qëllimi ynë strategjik është përforcimi i qasjes së Kosovës në fonde të jashtme, si IPA III, për periudhën 2021-2027 dhe, po ashtu, qëllimi ynë është t'i bashkojmë të gjithë për ndihmën e donatorëve me këtë instrument, në mënyrë që ta inkurajojmë bashkëpunimin dhe sinergjinë nëpërmjet ndihmës bilaterale", është shprehur Hoxha.
Ajo ka ftuar pjesëmarrësit në takim për të reflektuar mbi përparimin e arritur dhe për t'i shqyrtuar mundësitë për shfrytëzimin e mëtejshëm të ndihmës suedeze në forcimin e rrugës së Kosovës në BE.
Ndërkohë, ambasadorja e Suedisë në Kosovë, Karin Hernmarck-Ahliny, ka theksuar partneritetin e kamotshëm të Suedisë me Kosovën. Ajo ka treguar se në mënyrë bilaterale gjatë vitit të kaluar fondet suedeze të bashkëpunimit për reformën në Kosovë arritën shumën prej 94.4 milionë kronash suedeze apo rreth 8.5 milionë euro duke e bërë Suedinë donatoren e pestë më të madhe dypalëshe në Kosovë.
Hernmarck-Ahliny ka thënë se për këtë duhet shtuar fonde të konsiderueshme për përfitimin e Kosovës nga fondet e zhvillimit rajonal, garancitë kreditore, nga financimi themelor i sistemit të OKB-së në përgjithësi dhe nga bashkëpunimet e tjera institucionale. "Suedia vazhdon angazhimin e madh në Kosovë. Ne po punojmë me aktorët qeveritarë dhe institucionet si dhe me shoqërinë civile për të kontribuar në një sistem të drejtë, transparent dhe të përgjegjshëm të qeverisjes demokratike. Ne e mbështesim Kosovën në procesin e integrimit evropian dhe në përpjekjet për përmirësimin e jetës së të gjithë qytetarëve të saj. Në thelb të kësaj pune është barazia gjinore, mjedisi dhe ndryshimet klimatike, të cilat janë parakushte për një zhvillim të qëndrueshëm dhe të drejtë", ka deklaruar Hernmarck-Ahliny, duke shtuar se, përveç kësaj, Suedia vazhdon të përqendrohet në zgjidhjen e konflikteve dhe zbutjen e varfërisë. "Zhvillimi i sektorit privat është vendimtar në lidhje me këtë të fundit, jo më pak për krijimin e vendeve të punës që nevojiten për të inkurajuar talentet dhe ambiciet e rinisë së Kosovës. Në Kosovë dhe në Suedi, një shoqërie civile pluraliste, si dhe respektim themelor për të drejtat e njeriut, mbeten fushat kryesore të interesit. Ky është një parakusht për integrimin në BE, si dhe për arritjen e objektivave tona të përbashkëta ambicioze të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm", ka thënë ambasadorja suedeze.
Gjatë takimit delegacionet e udhëhequra nga ministrja Hoxha dhe ambasadorja Hernmarck-Ahliny kanë shqyrtuar përparimin në zbatimin e ndihmës së Suedisë për vitet 2014-2020 në vlerë prej 8-10 milionë eurosh në vit. Delegacionet konfirmuan se ndihma po zbatohet siç është planifikuar me 30 programe dhe projekte aktuale.

# Përmbyllet me sukses projekti për avancimin e sistemeve të telemjekësisë

EPOKA E RE Faton DËRMAKU



PRISHTINË, 28 MAJ - Qendra Kombëtare e Telemjekësisë së Kosovës ka përmbyllur me sukses projektin "Avancimi i sistemeve të telemjekësisë", me të cilin është arritur instalimi i sistemeve që ofrojnë kualitet të lartë komunikimi dhe mundësi më të mëdha për aplikimin e telemjekësisë në vende dhe rrethana të ndryshme.
Ky projekt është financuar nga ShSKUK-ja dhe Ministria e Shëndetësisë dhe është implementuar nga kompania Storm ICT.
I ndarë në dy vjet implementimi, faza e parë e këtij projekti është përmbyllur me sukses në tetor të vitit 2018, ku është bërë instalimi i sistemit për videokonferenca dhe sistemit të zërimit në amfiteatrin e Qendrës Kombëtare të Telemjekësisë në Prishtinë. Po ashtu, në këtë fazë është instaluar edhe infrastruktura qendrore për menaxhimin dhe ruajtjen e videokonferencave, si dhe integrimi i infrastrukturës së vjetër, në mënyrë që sistemi të vazhdojë të funksionojë edhe me sistemet e vjetra, derisa të përfundojë faza e dytë e këtij projekti dhe të gjitha sistemet e vjetra në qendrat rajonale të telemjekësisë të zëvendësohen me ato të reja.
Sistemi mobil i videokonferencave është kompletuar dhe funksionalizuar plotësisht dhe tani mund të përdoret qoftë për qëllime edukimi apo edhe transmetim nga ambiente të ndryshme si në salla operacioni.
Amfiteatri është pajisur me sistem videokonferencash me kualitet të lartë të imazhit dhe zërit, monitor dhe projektor për të shfaqur në të njëjtën kohë praninë lokale, atë në distancë dhe prezantimet.
Serverët e infrastrukturës qendrore janë instaluar dhe konfiguruar në dhomën e serverëve. Gjithashtu, për t'u përshtatur me specifikat e sistemeve të reja, në bashkëpunim me ofruesin e shërbimeve të internetit dhe VPN-it, janë bërë konfigurimet dhe përshtatjet e nevojshme të rrjetit.
Në fazën e dytë janë instaluar sistemet e reja dhe të avancuara në qendrat rajonale të telemjekësisë në spitalet e përgjithshme në Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren dhe Gjilan si dhe në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Skenderaj. Në këtë fazë, është bërë zgjerimi i rrjetit me dy qendra të reja të telemjekësisë në Spitalin e Përgjithshëm në Vushtrri dhe në Ferizaj.
Qendrat rajonale të telemjekësisë tashmë janë pajisur me kamera të cilësisë së lartë me transmetim imazhi të kualitet 4K, si dhe me pajisjet tjera si: TV me kualitet të lartë dhe audio sistem.
Pas përfundimit të instalimeve dhe konfigurimeve, është bërë trajnimi i stafit në secilën qendër në përdorimin, konfigurimin dhe mirëmbajtjen e këtyre sistemeve.
Këto pajisje kanë filluar të shfrytëzohen me kapacitet të plotë brenda rrjetit kombëtar të telemjekësisë, si dhe në nivel ndërkombëtar, duke ofruar kualitet dhe përvojë të jashtëzakonshme komunikimi.
Menaxhimi i këtij projekti është bërë me një nivel të lartë profesionalizmi nga ana e stafit të QKTK-SHSKUK, me një bashkëpunim dhe përkrahje të jashtëzakonshme nga ana e kompanisë implementuese.

# Thaçi: Roli i ShBA-së në dialog, i pazëvendësueshëm

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

**Prishtinë, 28 maj** - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka pritur të martën në takim ushtruesen e detyrës së drejtoreshës së Zyrës për Çështje të Evropës Jugore dhe Qendrore në Departamentin e Shtetit Amerikan (DASh), Susan Falatko, e cila shoqërohej edhe nga ambasadori amerikan në Prishtinë, Philip Kosnett. Thaçi dhe drejtoresha Falatko kanë biseduar për procesin e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, si dhe për sundimin e rendit dhe ligjit në Kosovë. "Kosova është e përkushtuar për forcimin e fqinjësisë së mirë. Dialogu duhet të vazhdojë pa kushte, me një mbështetje konsensuale të të gjitha shteteve të Kuintit", është shprehur Thaçi, duke theksuar se roli i ShBA-së është i pazëvendësueshëm.

Po ashtu, presidenti Thaçi ka theksuar se lufta ndaj krimit të organizuar, kontrabandës dhe korrupsionit është permanente dhe do të vazhdojë. "Institucionet vendore para një viti kanë marrë kompetencat në fushën e sundimit të ligjit dhe tani kemi një dinamikë të shtuar", ka thënë presidenti Thaçi.

Në anën tjetër, drejtoresha Susan Falatko ka theksuar rëndësinë që Kosova të mbetet e përkushtuar për forcimin e sundimit të ligjit dhe për arritjen e normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë. Ajo ka rikonfirmuar se ShBA-ja do të mbetet e përkushtuar për avancimin e interesave bilaterale dhe rajonale. Me këtë rast, presidenti Thaçi e ka falënderuar drejtoreshën Falatko për mbështetjen e vazhdueshme të ShBA-së. Edhe kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur në takim Susan Falatko. Ai ka thënë se ShBA-ja si aleate strategjike e Kosovës qëndron në krah të vendit tonë në konsolidimin e brendshëm dhe ndërkombëtar.



# Mësimdhënësit e viteve të '90-ta i presin pensionet e para pas qershorit

**Prishtinë, 28 maj** - Nga pjesa e dytë e këtij viti pritet të fillojë kompensimi shtesë për mësimdhënësit të cilët kanë punuar gjatë periudhës së viteve 1990-1999, në kuadër të procesit të njohur si sistemi paralel i arsimit në Kosovë. Ky kompensim u mundësohet në bazë të Ligjit për statusin e punëtorëve të arsimit shqiptar të Republikës së Kosovës nga viti 1990 deri më 1999, i cili është miratuar në muajin shkurt të këtij viti, por që ende nuk ka filluar zbatimi i tij në praktikë.

Mësimi në Kosovë gjatë viteve të '90-ta është zhvilluar nëpër shtëpitë-shkolla, sipas organizimit paralel që kishin vendosur atëkohë përfaqësuesit politikë shqiptarë, duke kundërshtuar nënshtrimin ndaj politikës së Beogradit dhe ish-liderit të atëhershëm serb, Sllobodan Milloshevriq.

Punëtorët, të cilët e kanë ushtruar profesionin e tyre gjatë asaj periudhe, pritet t'i marrin përfitimet pas daljes në pension. Ata do të marrin nga 19 deri në 95 euro, varësisht sa vjet kanë punuar në arsim.

Përfaqësues të Sindikatës së Bashkuar për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (SBAShK) kanë thënë se nxjerrja e disa akteve nënligjore ka bërë që të shtyhet ndarja e mjeteve financiare për përfituesit që, sipas tyre, është e panevojshme. Në bazë të këtij ligji, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MAShT) brenda gjashtë muajve që nga hyrja në fuqi e këtij ligji duhet t'i nxjerrë aktet nënligjore për zbatimin e tij.




Zyrtarë të Ministrisë së Arsimit thonë se konform procedurave dhe afateve kohore janë duke u hartuar dy udhëzime administrative që parashihen me ligj. Valmir Gashi, zëdhënës në këtë ministri, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se njëri udhëzim ka të bëjë me mësimdhënësit, tjetri me pronarët e shtëpive që janë shfrytëzuar për shkolla. Këto dy udhëzime, thotë ai, e përcaktojnë qartë gjithë procesin. Por, Ymer Ymeri, menaxher financiar në Sindikatën e Bashkuar për Arsim, Shkencë dhe Kulturë, thotë se periudha prej gjashtë muajsh ka qenë e panevojshme, pasi përgatitjet për këtë ligj kanë filluar ndër vite. "Ne si SBAShK kemi dhënë vërejtjet që MAShT-i është dashur të jetë pak më e shpejtë në nxjerrjen e udhëzimit. Edhe përkundër që ligji jep mundësi gjashtë muaj, ky është një ligj që e kemi pritur disa vjet, është ligj që vetë e ka sponsorizuar Ministria e Arsimit. Prandaj, është dashur të finalizohet ligji. Për këtë SBAShK-u nuk është i kënaqur sepse koha për dy-tre muaj pritje për një udhëzim administrativ prej 5-6 faqesh është e panevojshme", ka thënë Ymeri.

Agim Hajdari ka punuar profesor në shkollë të mesme gjatë viteve të '90-ta. Ka pesë vjet që kur ai është në pension dhe e quan të pakuptimtë zvarritjen e shpërndarjes së mjeteve. "Me të vërtetë e kanë vonuar shumë. Vonesat në ndarjen e mjeteve shfaqen vetëm që të vdesin më shumë pensionistët dhe qeverisë që t'i vijë më lehtë ta bëjnë pagesën ndaj pensionistëve, të cilët 10 vjet nuk kanë kursyer asgjë për të punuar edhe në kushte të rrezikshme", ka thënë Hajdari.

Megjithatë, pas përfundimit të këtyre procedurave, Ymer Ymeri shpreson se pas muajit qershor do të fillojë ndarja e mjeteve për përfituesit, kurse në mënyrë retroaktive do ta marrin kompensimin shtesë që nga hyrja në fuqi e ligjit. "Edhe pse ministria ka afat deri në fund të muajit gusht për nxjerrjen e udhëzimeve administrative, mendojmë se nga fundi i muajit qershor do të nënshkruhet udhëzimi administrativ. Kështu që, mësimdhënësit që janë përfitues do t'i marrin shtesat në pension prej hyrjes në fuqi të këtij ligji. Kështu që përfituesit, mjetet shtesë do t'i marrin në mënyrë retroaktive", ka thënë Ymeri. Sipas SBAShK-ut, rreth 7 000 është numri i mësimdhënëseve të cilët kanë punuar në atë periudhë dhe që janë përfitues.

Kostoja e zbatimit të ligjit, sipas një përgjigjeje të mëhershme të Ministrisë së Arsimit, për vitin 2019 do të jetë 6.6 milionë euro dhe për vitin 2020 rreth 7.4 milionë euro. Bazuar në një llogaritje të bërë, një mësimdhënës që ka punuar nëntë vjet do "shpërblehet" me 95 euro në muaj dhe pension kontributpagues prej 260 eurosh. Kjo nënkupton se ata do të paguhen 355 euro në muaj, kurse shuma do të jetë më e vogël për mësimdhënësit që kanë punuar më pak vjet. Ndërkaq, në rast se personi ka ndërruar jetë, të drejtë kompensimi ka bashkëshortja ose bashkëshorti. Përveç mësimdhënësve, sipas ligjit, edhe pronarët e shtëpive që në atë kohë kanë lëshuar objektet e tyre që të shfrytëzohen si shkolla, do të gëzojnë përfitime si dhe punëtorët teknikë dhe shërbyesit.

# Shala dhe Begaj përurojnë Inkubatorin e Bizneseve në Malishevë



**Prishtinë, 28 maj (ER)** - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, bashkë me kryetarin e Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, kanë prerë shiritin për nisjen e punimeve në Inkubatorin e Bizneseve në këtë komunë, që është investim i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Ministri Shala ka thënë se do të krijohet një hapësirë prej 600 metrash katrorë për bizneset e vogla, që të operojnë dhe do të kontribuojnë në rritjen e punësimit. "Ishim bashkë për t'i parë punimet që janë duke u zhvilluar në Inkubatorin e Biznesit në Komunën e Malishevës, investim ky i realizuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, ku do të krijohet një inkubator biznesi i cili do të krijojë një hapësirë mbi 600 metra katrorë për bizneset e reja të Komunës së Malishevës. Krejt kjo po bëhet për bizneset tona në Republikën e Kosovës, në këtë rast në Komunën e Malishevës, që t'u krijojmë mundësi për zhvillimin e afarizmit të tyre. Njëkohësisht, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë shumë shpejt do të bëjë investime edhe në infrastrukturë në Zonën Ekonomike të Komunës së Malishevës", u shpreh Shala.

Ai e ka siguruar kryetarin Begaj se kjo komunë nuk do të anashkalohet më nga pushteti qendror, por do të ketë edhe investime të tjera. "Unë dua ta siguroj kryetarin e Komunës së Malishevës, deputetët e zonës dhe të gjithë banorët e Komunës së Malishevës për përkushtimin tim personal si ministër, por edhe të Qeverisë së Republikës së Kosovës, që kjo komunë tash e tutje të mos jetë si 'zorre qorre' siç është trajtuar së fundi, por do të trajtohet ashtu si të gjitha komunat e tjera të Republikës së Kosovës në mënyrë që edhe në Komunën e Malishevës të investohet dhe të krijohen mundësi për bizneset", ka deklaruar Shala.

Ndërsa kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka thënë se ky inkubator do t'u shërbejë bizneseve të vogla që të kenë kushte sa më të mira për të funksionuar. "Do të jetë një vend ku do të jenë bizneset e Malishevës dhe do të kenë kushte më të mira për veprim dhe do të jetë edhe një ndihmë për neve si komunë. Njëkohësisht, edhe zona ekonomike është një derë e hapur e zhvillimit të Malishevës që do të shërbejë si një arterie e cila do ta ndihmojë Malishevën dhe bizneset e diasporës", ka thënë Begaj.

Në nisjen e punimeve të këtij inkubatori morën pjesë edhe deputetët Haxhi Shala dhe Enver Hoti, zëvendësministrja e MTI-së Arbëreshë Krasniqi dhe zëvendësministri i MBPZhR-së, Vesel Krasniqi.

# Reçica: Rritja e punësueshmërisë kërkon reforma ligjore dhe modernizim të shërbimeve të punësimit

**Prishtinë, 28 maj (ER)** - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka marrë pjesë të martën në konferencën e Bankës Botërore me temë "Si të punojmë së bashku për t'i rritur mundësitë e punësimit për të rinjtë në Kosovë". Në këtë konferencë, ministri ka folur rreth përkushtimit të MPMS-së për ngritjen e nivelit të punësueshmërisë në vend, e posaçërisht punësueshmërinë e të rinjve.

Ai ka theksuar se plani i punësimit të të rinjve ka paraparë objektiva specifike për punësimin e të rinjve, duke u fokusuar në arsimin dhe aftësimin profesional të të rinjve, grave dhe grupeve të cenueshme. "Për të rritur punësueshmërinë në vend, duhet të krijohen disa parakushte, qoftë reforma ligjore, qoftë edhe ato teknike, andaj MPMS gjatë kësaj periudhe ka realizuar një sërë reformash ligjore si dhe në modernizimin e ofrimit të shërbimeve", ka deklaruar Reçica.

Ministri Reçica së bashku me drejtorin e Bankës Botërore për Kosovë, Marco Mantovaneli, kanë ndarë disa çmime për studentët dhe të rinjtë të cilët kanë marrë pjesë në garën e Bankës Botërore, për idetë dhe shpresat e tyre mbi tranzicionin nga studimet në botën e punësimit.





## 26 milionë euro për ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në Gjilan

**Gjilan, 28 maj (ER)** - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, drejtori i Bankës Evropiane për Zhvillim (BERZh) në Prishtinë, Neil Taylor dhe drejtori i kompanisë së ujësjellësit "Hidromorava", Muhamet Suliqi, kanë nënshkruar një marrëveshje në vlerë prej 26 milionë eurosh për ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza. Haziri ka thënë se ky impiant do të ketë kapacitet për 76 mijë banorë dhe puna do të nisë në vitin e ardhshëm.

# Haradinaj: Qeveria e pakompromis në luftën kundër informalitetit

"Jemi të përkushtuar të krijojmë kushte të volitshme për bizneset vendore dhe të huaja dhe kemi ndërmarrë një varg masash të cilat ndikojnë në zhvillimin ekonomik, si: krijimin e zonave të lira ekonomike, Ligjin për Investime Strategjike, kemi fuqizuar luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve ekonomike", ka thënë kryeministri Haradinaj në takimin me përfaqësuesit e asocioneve të bizneseve

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 28 MAJ - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të martën në takim përfaqësuesit e Odës Ekonomike të Kosovës, Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare, Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, si dhe përfaqësues të 15 bizneseve, me të cilët ka biseduar rreth zhvillimeve më të fundit ekonomike në vend dhe për shtimin e bashkëpunimit ndërmjet qeverisë dhe sektorit privat. Haradinaj ka shprehur përkushtimin e tij dhe të Qeverisë së Kosovës për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, për luftën e pakompromis ndaj informalitetit dhe dukurive të tjera negative që ngufasin konkurrueshmërinë dhe zhvillimin normal të veprimtarive ekonomike në vend. "Jemi të përkushtuar të krijojmë kushte të volitshme për bizneset vendore dhe të huaja dhe kemi ndërmarrë një varg masash të cilat ndikojnë në zhvillimin ekonomik, si: krijimin e zonave të lira ekonomike, Ligjin për Investime Strategjike, kemi fuqizuar luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve ekonomike", ka thënë kryeministri Haradinaj.

Ai ka kërkuar nga përfaqësuesit e bizneseve që ta rrisin bashkëpunimin dhe t'i ndërmarrin veprimet e nevojshme për përmirësimin e klimës së biznesit dhe përmirësimin e kushteve të punës për punëtorët veçmas në sektorin privat. "Krijimi i një mekanizmi bashkëveprues mes institucioneve të vendit dhe përfaqësuesve të odave ekonomike kosovare është një veprim i nevojshëm, në të mirë të fuqizimit ekonomik të vendit, luftimin e ekonomisë joformale, rritjes së prodhimit dhe eksportit", është shprehur kryeministri Haradinaj dhe ka vlerësuar se përmbyllja e infrastrukturës ligjore, fiskalizimi, raportimi financiar, luftimi i konfliktit të interesit, Gjykata e Specializuar Ekonomike, janë veprime të nevojshme për avancimin e funksionimin e drejtë dhe ligjor të kësaj veprimtarie si dhe ndihmon në hapjen e vendeve të reja të punës dhe rritje ekonomike të vendit.

Ndër temat e këtij takimi ishin edhe veprimet ndërinstitucionale për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik bazuar në resurset njerëzore dhe ato natyrore, punësimi formal, koordinimi më i mirë i punëve ndërmjet ATK-së, Inspektoratit të Punës, inspektorateve komunale dhe Bankës Qendrore, ndryshimi i Ligjit për të ardhurat personale, ndërtimi i një platforme për raportimet për punësimin informal në të cilin ruhet privatësia si dhe raportimi i orëve shtesë që nuk u paguhen punëtorëve.



# KRU 'Prishtina' vazhdon mbajtjen e ligjëratave për fëmijë




PRISHTINË, 28 MAJ (ER) - Fëmijë nga niveli parashkollor dhe nga kopshti "Bota e Çudirave" në Prishtinë kanë vizituar të martën Kompaninë Rajonale të Ujësjellësit "Prishtina". Vizita u realizua në Fabrikën e Trajtimit të Ujit në Shkabaj. "Rreth 20 fëmijëve parashkollorë të këtij kopshti stafi i ujësjellësit të Prishtinës u mbajti një ligjëratë elementare për vlerat e pamohueshme, rëndësinë dhe përdorimin e drejtë të ujit të pijshëm. Fëmijët e vegjël ishin mjaft të lumtur që vizituan fabrikën më të madhe të ujit të pijshëm në Republikën e Kosovës", është thënë në njoftimin për media të Kompaninë Rajonale të Ujësjellësit "Prishtina".

KRU "Prishtina" që nga java e kaluar është duke mbajtur ligjërata për fëmijë, duke filluar nga parashkollorët, që të vazhdojë më pas edhe me nxënës të shkollave fillore.

## Komuna e Malishevës dhe Avokati i Popullit pajtohen për ta vazhduar bashkëpunimin

**Malishevë, 28 maj (ER)** - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, dhe zyrtarja për barazi gjinore, Vera Bytyçi, kanë pritur të martën në një takim pune zëvendësavokaten e Popullit, Naile Alajn, me të cilën kanë biseduar për bashkëpunimin e deritanishëm në mes të dy institucioneve dhe janë zotuar për vazhdimin e bashkëpunimit të mirë edhe në të ardhmen.
Zëvendësavokatja e Popullit, Naile Alaj, e ka vlerësuar lart bashkëpunimin me Komunën e Malishevës dhe e ka falënderuar komunën për këtë bashkëpunim dhe gatishmërinë e saj për të bashkëpunuar për të gjitha çështjet që lidhen me punën e institucionit të Avokatit të Popullit.
Ndërsa kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka shprehur gatishmërinë e komunës për bashkëpunim, duke theksuar se janë të gatshëm që për të gjitha çështjet që adresohen të përgjigjen.





## Skenderaj përkujton dëshmorët dhe martirët e lirisë

**Skenderaj, 28 maj (ER)** - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, nënkryetari Nuredin Lushtaku, deputeti i Kuvendit të Kosovës, Bekim Haxhiu, familjarë, bashkëluftëtarë, përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, si dhe qytetarë, kanë përkujtuar dëshmorët e kombit Mustafë Haxhiu-Bacoku, Gëzim Ferizi, Isuf Aliçkaj, si dhe martirin Bedri Haxhiu, të cilët 20 vjet më parë ranë heroikisht për lirinë e popullit të Kosovës. Me këtë rast, deputeti Haxhiu ka thënë se Mustafë Haxhiu-Bacoku ishte një luftëtar trim, i pathyeshëm, guximtar dhe udhërrëfyes se si duhet të vdiset për atdhe. "E patëm njërin nga bashkëluftëtarët që nuk na ndanin aksionet dhe betejat, por na ndau vetëm vdekja", ka thënë Haxhiu.

## Rehabilitohen rrugët në lagjen 'Jeni Mahallë' të Prizrenit

**Prizren, 28 maj (ER)** - Komuna e Prizrenit ka bërë me dije se Drejtoria e Shërbimeve Publike ka përfunduar punimet në dy rrugët e lagjes "Jeni Mahallë" në këtë komune. Kjo komunë ka theksuar se me rregullimin e këtyre rrugëve është përmirësuar dukshëm gjendja rrugore në këtë lagje. "Drejtoria e Shërbimeve Publike ka përfunduar punimet për rehabilitimin e rrugëve në lagjen 'Jeni Mahallë', më saktësisht në rrugët 'Gjeravica' dhe 'Xhemil Fluku', ku është bërë rehabilitimi dhe shtrimi i rrugëve me asfalt, duke e përmirësuar dukshëm gjendjen në aspektin rrugor", ka njoftuar Komuna e Prizrenit.




## Në Mitrovicë, për nder të festës së fitër bajramit, këtë të diel do të punojnë subjektet afariste



**Mitrovicë, 28 maj (ER)** - Komuna e Mitrovicës ka njoftuar të gjitha subjektet afariste të komunës, se dita e diel, 02.05.2019, para festës së fitër bajramit, do të jetë ditë pune në Mitrovicë. Ky vendim është marrë nga kryetari i komunës, Agim Bahtiri, me qëllim që t'i mbështesë bizneset dhe që qytetarët të furnizohen me gjëra të konsumit në prag të festës së fitër bajramit, duke mundësuar kështu që e diela e parë e muajit qershor të jetë ditë pune për bizneset në qytetin e Mitrovicës, gjithmonë duke respektuar Rregulloren Komunale Nr. 03/2014. "Gjithashtu njoftojmë të gjithë qytetarët se me përjashtim të ditës së diel, me datë 02.05.2019, do të vazhdojë të jetë në fuqi vendimi i kryetarit Bahtiri që e diela dhe festat zyrtare të jenë ditë pushimi në tërë territorin e Komunës së Mitrovicës, ndërkohë që Drejtoria e Inspeksionit do t'i vazhdojë inspektimet te subjektet afariste për respektimin e këtij vendimi dhe Rregullores komunale Nr. 03/2014 për caktimin e orarit të punës për subjektet afariste në Komunën e Mitrovicës", është thënë në njoftimin e Komunës së Mitrovicës.

## Ndihmohen 250 familje skamnore të Ferizajt

**Ferizaj, 28 maj (ER)** - Drejtoria Komunale e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Ferizaj, në bashkëpunim edhe me organizatën "Qatar Charity", në prag të festës së Fitër Bajramit ka ndihmuar rreth 250 familje skamnore me pako ushqimore. Lista e familjeve të përzgjedhura për të ndihmuar është bërë nga Qendra për Punë Sociale në Ferizaj. Me këtë rast është vlerësuar tejet lart kontributi i kësaj organizate që ka ndihmuar këto familje në prag të festës së bajramit. Ndërsa familjet që kanë përfituar këto ndihma kanë falënderuar këtë organizatë dhe Komunën e Ferizajt që sadopak po i ndihmon me rastin e kësaj feste.



# E PSE JO NJË SHTET?

"Analistët" kanë marrë përsipër të na e mbushin mendjen se ekzistenca e dy shteteve shqiptare apo mosbashkimi me Shqipërinë është për të mirën e shqiptarëve!



Nga Ismet HAJRULLAHU

E pse jo dy? Po sa? Një! E pse jo një? Po sa? Dy! Zakonisht ndejave pranë zjarrit të vatrës, netëve të mërzitshme e të plogështa të dimrit, është luajtur kungulleshkash me fëmijët. Ditët e fundit disa analistë në Kosovë, të cilëve moti u ka kaluar edhe puberteti, të paktën ai fiziologjik, kanë filluar të luajnë kungulleshkash me çështjen kombëtare. Përmes shtypit ditor, me do artikuj që shpesh u përngjajnë shkrimeve seminarike, kanë marrë një nismë, disi të vështirë dhe po hyjnë në sallë provimesh me koncepte të papërtypura mirë e, për rrjedhojë, bëjnë dhe autogol. Për të mos u zgjatur, shkas për këtë shkrim dhe për kundërpërgjigjen time, njëkohësisht u bënë artikujt e B. Shalës, "E pse jo dy shtete?" ("Zëri", 13 prill, 2010) dhe të H. Matoshit "Bashkimi me Shqipërinë" ("Koha ditore", 14 dhe 15 prill 2010).

Të dy analistët kanë marrë përsipër të na e mbushin mendjen se ekzistenca e dy shteteve shqiptare apo mosbashkimi me Shqipërinë, është për të mirën e shqiptarëve.

Argumentet e sjella nga ana e tyre, për ta mbështetur tezën e mësipërme, fillojnë qe nga loja e kungulleshkës dhe deri te teori të ndryshme për shtetin dhe për kombin, por që kanë prodhuar më shumë konfuzitet sesa i kanë ofruar vetes dhe lexuesit qartësi dhe rrugëzgjidhje të çështjes në fjalë.

Thjesht e kemi pranuar ekzistencën e dy shteteve si zgjidhje për t'i dhënë fund sundimit të shovinizmit serb dhe për mbrojtjen e dinjitetit dhe të të drejtave themelore të mohuara të shqiptarëve në Kosovë. E kemi pranuar zgjidhjen e ofruar se nuk na është lejuar më shumë. Dhe së fundi, e kemi pranuar zgjidhjen e dy shteteve se nuk ka ndonjë vullnet politik, as kësaj ane dhe as asaj ane të kufirit për ndonjë debat a diskutim mbarëpopullor për një bashkim të mundshëm.

Ideja se ekzistenca e dy shteteve është interes jetik dhe strategjik i kombit shqiptar i sjellë nga analisti Shala, në mungesë të shtjellimit të argumentit nga ana e tij, na shtyn të mendojmë se me të njëjtën logjik ekzistenca e dy Gjermanive do të ishte sa jetike, aq dhe strategjike: Dy kombe gjermane në BE, dy kombe gjermane në OKB, dy kombe gjermane në NATO, dy kombe gjermane në FMN, dy kombe gjermane në OSBE, dy kombe gjermane në OTB, dy kombe gjermane në... Po me sa duket gjermanët vendosën t'i zhbëjnë e t'i shpërfillin këto interesa jetike se kishin vendosur ta "zvogëlonin" sferën e influencës përmes ribashkimit dhe kishin vendosur, sipas logjikës suaj dhe argumentit teorik që sillni për shtetinkomb, preferuan të ndjekin modele "marksiste-leniniste" të shtetformimit dhe të zgjidhjes së çështjes kombëtare.

Bashkimi i dy Gjermanive, z. Shala, ishte rezultat jo i dëshirës së komunitetit ndërkombëtar e në mënyrë të veçantë fituesve të luftës së Dytë Botërore, Britanisë, Rusisë (ish-Bashkimi Sovjetik) dhe Francës, (me përjashtim të ShBA-së, e cila ishte mbështetësja kryesore e ribashkimit). Të tri ishin kundër, madje Britania, përmes znj. Thatcher, ishte kundërshtarja më e flaktë e bashkimit të dy "kombeve". Argumenti i znj. Thatcher ishte se një Gjermani e bashkuar do të ishte më e fuqishme dhe do t'i prishte balancat e krijuara, do ta dominonte politikën evropiane ekonomikisht dhe në forma të tjera. Natyrisht, Gjermania përbën një shtet të fuqishëm, por nuk ka prishur balanca, përkundrazi vazhdon të kontribuojë në BE e në NATO, nuk ka shenja të revanshizmit ose të militarizimit. Mbi të gjitha, të mos harrojmë, ribashkimi i Gjermanisë shënoi fillimin dhe aktin e zgjerimit të BE-së përmes anëtarësimit të shteteve ish-komuniste. E pra, thënë hapur, siç juve s'ju pëlqen të flisni në shkrimin tuaj, zgjidhja njëherë e mirë e çështjes shqiptare do të kontribuonte në forcimin e paqes dhe të stabilizimit në Ballkan! Sa për argumentet e ofruara nga z. Matoshi, si fillim një këshillë, që gjithë kjo punë studimore e teorive të kombit, ndonëse e prezantuar vetëm nëpërmjet teorive, që ju shkojnë për shtat, të mos ju shkojë kot mundi, bëni ndonjë bibliografi e ua ofroni studentëve të shkencës politike, për të mos humbur kohë duke rrëmuar bibliotekat. Së dyti, z. Matoshi, ata që nuk mendojnë si ju dhe ndajnë të njëjtin opinion për mosbashkim me Shqipërinë, si fillim bëni mirë të hiqni dorë nga kategorizimet dhe emërtimet "komuniste" e "nacionaliste", se atëherë ne duhet t'ju quajmë tradhtarë! Një emërtim dhe një karakterizim, natyrisht i pabazë për figurën tuaj, ngaqë unë mendoj se ju njoh si patriot! Së treti, se ne mbështetësit e teorisë së kombit-shtet, duke ju cituar juve, "sillemi si kalamaj mbi kalin e Skënderbeut, duke kërkuar rrënjët e kombit si mit mesjetar, madje dhe në prehistori" është larg së vërtetës. Dhe meqë vetë na e keni servirur, nuk do të ishte keq që politikanë, analistë, e studiues, në radhë të parë të mësonin diçka e, ndoshta, pse jo të vepronin në fushën e diplomacisë, nga aleancat dhe aftësitë për të lidhur të tilla, nga heroi ynë kombëtar. Historia e kombit, me një ose dy shtete, ose dhe pa shtete, nuk fillon me mua, me ju dhe me z. Shala, as me klasën politike të së sotmes. Po fillon me ato rrënjët e përbuzura nga ana juaj, të cilat ju na i ktheni në koncepte mitike apo prehistorike nga pikëpamja kohore.

Nëse një pjesë jona jetuaka në mitologji dhe në prehistori, mendoj se ju dhe z. Shala jetoni në një botë iluzive e deluzionare teksa e shihni ekzistencën e dy shteteve si të vetmen mënyrë për ekzistencën dhe prosperitetin e kombit!

**(Ky shkrim është botuar në vitin 2010 në disa nga mediat e shkruara të Kosovës)**

# Vitia dhe Ferizaj lidhen në autostradën 'Arbën Xhaferi'



Viti, 28 maj (ER) - Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar të martën kërkesën e Vitisë dhe të Ferizajt për kyçjet shtesë në autostradën "Arbën Xhaferi". Kyçja e Gërlicës së Vitisë, ajo në hyrje të Ferizajt dhe ndërtimi i mbikalimit të Paldenicës së Hanit të Elezit, janë kërkesa të parashtruara nga banorët dhe drejtuesit e komunave në fjalë si dhe një grupi të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga legjislatura e kaluar, të miratuara edhe nga anëtarët e Komitetit Drejtues Ndërministror për Zhvillimin e Projektit të Autostradës R6. "Meqë këto ndërhyrje nuk kanë qenë pjesë e projektit fillestar, në vazhdim nevojitet projektim dhe ndërtim i tyre, punë kjo që do të bëhet nga konsorciumi 'Bechtel Enka', punëkryes të tërë autostradës. Vendimi për procedim të mëtutjeshëm të punëve në këto projekte është dëshmi e vendosmërisë së qeverisë Haradinaj, ministrit të Infrastrukturës dhe Transportit Pal Lekaj, për plotësim të premtimeve të dhëna ndaj qytetarëve", është bërë me dije në njoftimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit. Autostrada "Arbën Xhaferi" do të hapet për qarkullim të automjeteve sot (e mërkurë).

## U shënua Dita e Qendrës së Kulturës "Mensur Zyberaj" në Rahovec

Rahovec, 28 maj (ER) - Nën organizimin e kryetarit të Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, të martën me aktivitete të shumta është shënuar Dita e Qendrës së Kulturës "Mensur Zyberaj" në Rahovec, kurse pjesëmarrës ishin zyrtarë komunalë, familjarë dhe bashkëluftëtarë të dëshmorëve.

Aktivitetet kanë filluar me homazhe dhe nderime te pllaka përkujtimore e heronjve dhe dëshmorëve: Mensur Zyberaj, Ismail Gashi, Habib Gashi, Kurtish Hasani, Bedri Berisha, Nazmi Hasani, Manush Berisha, Agron Bytyqi, Alajdin Elshani, Xhevat Elshani, Selim Berisha, Hajrush Berisha dhe Rifat Dina. Pastaj është mbajtur programi kulturor-artistik dhe ekspozita "Koleksioni i pikturave të kolonisë së artistëve" nga OJQ "Art Studio" në hollin e Qendrës së Kulturës "Mensur Zyberaj".

Smajl Latifi, kryetar i Komunës së Rahovecit, në fjalimin e tij të mbajtur në akademi solemne, ka thënë se 28 maji është skalitur me shkronja gjaku në historinë e popullit të Rahovecit, ngaqë me këtë datë të vitit 1999 në fushë të nderit ranë shumë dëshmorë në betejën e ashpër dhe të pabarabartë që u zhvillua në zonën e Mileskës.

Kjo beteje e majit mori përmasa gjaku e heroizmi ngaqë në fushë të nderit ranë shumë dëshmorë, ndër të cilët edhe një ndër themeluesit e celulave të para të UÇK-së në rajonin e Anadrinisë, respektivisht Zonës Operative të Pashtrikut, heroi i Kosovës Mensur Zyberaj.



## Hunt synon ta zëvendësojë Theresa May

LONDËR, 28 MAJ - Kandidati i Partisë Konservatore për kryeministër britanik, Jeremy Hunt, ka paralajmëruar se partia e tij do të shkaktojë "vetëvrasje politike" nëse tenton ta avancojë idenë e largimit të Britanisë nga Bashkimi Evropian pa marrëveshje. Hunt, aktualisht ministër i Jashtëm, është një nga 10 personat që synon ta zëvendësojë Theresa May. Në një shkrim për "The Daily Telegraph", ai shprehet se konservatorët do ta pësojnë keq nëse përballen me zgjedhje të përgjithshme para se të finalizohet procesi i Brexitit. "Gjithmonë kam thënë se një Brexit pa marrëveshje është mundësi më e mirë sesa anulimi i të gjithë procesit të largimit, por situata e dëshmon se nëse një kryetar ekzekutivi mbron këtë ide, rrezikon të përballet me votë mosbesimi, çka do të rezultonte me mbajtje të zgjedhjeve të përgjithshme", thotë ai.

Në përgjigje të kësaj deklarate, një nga rivalët e ministrit Hunt, Esther McVey, ka thënë se "vetëvrasje politike" do të përbënte fakti nëse Britania nuk largohet nga blloku evropian në fund të tetorit, ashtu siç është planifikuar. Theresa May ka njoftuar javën e kaluar se më 7 qershor do të largohet nga pozita e lideres së Partisë Konservatore në Britani, duke i hapur rrugë procesit të zgjedhjes së kryeministrit të ri.




# Netanyahu përpiqet ta shmangë përsëritjen e zgjedhjeve

Nëse kryeministri Benjamin Netanyahu nuk siguron mbështetjen e duhur deri sot (e mërkurë) në mbrëmje, parlamenti do të shpërndahet dhe vendi do të zhvillojë zgjedhje të reja më 28 gusht, por ai premtoi se do të bënte gjithçka të mundur për ta mënjanuar përsëritjen e zgjedhjeve të kushtueshme




TEL-AVIV, 28 MAJ - Izraeli po përballet me një krizë politike pas dështimit të kryeministri Benjamin Netanyahu për formimin e një koalicioni qeveritar. Nëse ai nuk siguron mbështetjen e duhur deri sot (e mërkurë) në mbrëmje, parlamenti do të shpërndahet dhe vendi do të zhvillojë zgjedhje të reja më 28 gusht.

Gjatë një fjalimi të hënën, Netanyahy premtoi se do të bënte gjithçka të mundur për ta mënjanuar përsëritjen e zgjedhjeve të kushtueshme. "Brenda 48 orëve mund të bëhen shumë gjëra. Dëshirat e votuesve mund të respektohen. Një qeveri e fuqishme e krahut të djathtë mund të formohet. Ne mund të sjellim stabilitet dhe qeverisje të mirë në Izrael. Shpresoj që njerëzit të arsyetojnë dhe të bëjnë atë që duhet", tha ai.

Netanyahu nuk arriti të bënte marrëveshje me kreun e partisë nacionaliste "Yisrael Beiteinu", Avigdor Lieberman, si rezultat i mospajtimit për një projektligj që rregullon përjashtimin nga shërbimi ushtarak të studentëve "haredi yeshiva" (që i përkasin fesë hebraike ultra-ortodokse). Përjashtimi nga shërbimi ushtarak ka qenë një çështje e debatueshme për shumë vite në vendin ku ushtria është e detyrueshme.

Lieberman po kërkon shtimin e numrit të hebrenjve ultra-ortodoksë në forcat e armatosura dhe gjoba për institucionet që nuk e respektojnë këtë. Por partitë ortodokse duan më shumë përjashtime nga radhët e ushtrisë. Netanyahu ka nevojë për Lieberman dhe partitë ultra-ortodokse për të formuar një shumicë qeverisëse. "Duam të formojmë një qeveri ku do të jetë e qartë se nuk do të ketë kompromis në ligjin për shërbimin ushtarak për ultra-ortodoksët. Nuk është diçka që ne e fshehim", tha kreu i partisë 'Yisrael Beiteinu' Avigdor Lieberman.

Të hënën Parlamenti izraelit ndërmori hapin e parë drejt zgjedhjeve të reja duke i dhënë miratimin paraprak një ligji për shpërndarjen e parlamentit. Duhen edhe tri vota për miratimin përfundimtar të ligjit, i cili do të çonte në zgjedhje të reja.

Benny Gantz, drejtues i aleancës opozitare "Blue and White", e kundërshton ligjin dhe thotë se i duhet dhënë një shans partisë së tij për të ndërtuar një koalicion. Ganz ishte rivali kryesor i Netanyahut në zgjedhjet e prillit. "Grupi ynë do ta kundërshtojë shpërndarjen e parlamentit për një arsye të thjeshtë, se zgjedhjet në këtë kohë janë një truk politik", tha Ganz.

# Delegacioni amerikan viziton Lindjen e Mesme

UASHINGTON, 28 MAJ - Këshilltari i lartë në Shtëpinë e Bardhë, Jared Kushner, po kryeson një delegacion të Shteteve të Bashkuara në Lindjen e Mesme, në përpjekje për të fituar mbështetje për planin e paqes të cilin pritet ta paraqesë së shpejti presidenti i ShBA-së, Donald Trump.




Kushner dhe përfaqësuesi i ShBA-së për Lindjen e Mesme, Jason Greenblatt, ka dy vjet që po punojnë në këtë plan, që synon dhënien fund të konflikteve disadekadëshe në Lindjen e Mesme.

Ky udhëtim është i ngjashëm me atë që delegacioni amerikan e zhvilloi në muajin shkurt në vendet e Gjirit Persik. Një arsye për udhëtimin e kësaj jave është të rritet mbështetja për një konferencë të planifikuar për 25 dhe 26 qershor në Manama, Bahrejn, në të cilën Kushner do ta zbulojë pjesën e parë të planit shumë të pritur të paqes izraelito-palestineze.

Plani, i cilësuar nga presidenti Trump si "marrëveshja e shekullit", është t'i inkurajojë investimet në Bregun Perëndimor dhe Rripin e Gazës nga vendet donatore arabe përpara se të fillohet me zgjidhjen e çështjeve politike që janë në "epiqendër të konfliktit".

Aspekti ekonomik i planit të paqes parashikon investime në shkallë të gjerë dhe projekte infrastrukturore në territoret palestineze.

Por, elementet kryesore politike mbeten kryesisht të panjohura dhe konferenca në Bahrejn nuk pritet t'i trajtojë pjesët më kontestuese të konfliktit: kufijtë, statusin e Jerusalemit, refugjatët palestinezë dhe sigurinë e Izraelit. Udhëheqësit palestinezë kanë qenë shumë kritikë ndaj kësaj përpjekje. Megjithatë, Arabia Saudite dhe Emiratet e Bashkuara Arabe kanë thënë se do të marrin pjesë në konferencë.

## Presidenti austriak shpërbën qeverinë pasi kancelari humbi votëbesimin

VJENË, 28 MAJ - Presidenti i Austrisë e shpërbëri zyrtarisht të martën qeverinë e vendit, një ditë pasi kancelari Sebastian Kurz humbi një votëbesim në Parlament. Pas kësaj, presidenti Alexander Van der Bellen emëroi përkohësisht të njëjtët ministra të kabinetit, përsëri në rolet e tyre të mëparshme, për t'u siguruar që qeveria të funksionojë siç duhet, deri në emërimin e një qeverie kalimtare. Kjo pritet të ndodhë brenda javës së ardhshme dhe qeveria e përkohshme do ta qeverisë Austrinë deri në zgjedhjet e reja në shtator.

Zëvendëskancelari i Kurzit, ministri i Financave Hartwig Loeger, merr përsipër detyrat e kancelarit derisa të emërohet qeveria e përkohshme. Pavarësisht humbjes së votëbesimit, që u mbështet nga ish-partneri i koalicionit dhe nga opozita Social Demokrate, Kurz dhe Partia e tij Popullore gëzojnë një përkrahje në rritje në anketa dhe mendohet se mund të paraqiten edhe më mirë në zgjedhjet e vjeshtës.



# Florentina Ferati (Tina) nga Ferizaj, inxhiniere e sigurisë kibernetike në 'Facebook'

Florentina Ferati është eksperte e kibernetikës dhe teknologjisë. Më 2015 u bë kosovarja e parë që u punësua në kompaninë "Facebook" si inxhiniere e sigurisë kibernetike




**Shkruan: AFRIM MUSTAFA,**
***Reporter dhe veteran i luftërave të UÇK-së***

Lindi në fshatin Pleshinë të Ferizajt, në motin e vështirë 1989. Një vit më vonë, Serbia ripushtoi Kosovën, duke larguar nga puna e duke përndjekur mijëra shqiptarë. Babai i Florentinës, Avdiu, që punonte në fabrikën "Eurometal" dhe nëna Igballe, infermiere, mbetën pa punë.

Me Florentinën pesëvjeçare dhe katër fëmijë të tjerë ata mërguan në Munih të Gjermanisë në vitin 1994. Florentina nuk dinte asnjë fjalë gjermanisht. Por, shpejt nxuri gjuhën dhe kreu katër klasat e para të fillores me sukses të lartë.



E interesuar qysh herët për teknologjinë dhe ndërmarrësinë, Florentina dhjetëvjeçare shiste gjësende të përdorura e suvenire në treg për të fituar para xhepi për veten dhe për të blerë lodra kompjuterike.

Mësoi qysh atëherë të mos zmbrapsej përballë sfidave. Në vitin 2000, ca kohë pasi kishte mbaruar lufta, familja e saj u kthye në fshatin Pleshinë, ku Tina u regjistrua në klasën e pestë të shkollës "Pesë Dëshmorët e Kombit". Ndonëse s'kishte bërë asnjë ditë mësim në gjuhën shqipe, u dallua si nxënëse e brezit të saj, duke përfaqësuar shkollën në gara akademike e sportive. Me sukses të shkëlqyeshëm, u regjistrua në Gjimnazin "Kuvendi i Arbërit" në Ferizaj, duke zgjedhur drejtimin Matematikë-informatikë që i flinte në zemër.

Rrugëtimi i Florentinës deri te punësimi i saj në gjigantin botëror "Facebook", filloi me studimet e bachelorit, të cilat ajo i ndoqi në Texas Lutheran University (TLU).

Krahas shkollës, Florentina u angazhua në shoqërinë civile, duke ndihmuar organizatat joqeveritare që vëzhgonin punën e komunës, kërkonin shërbime më të mira për qytetarët dhe punonin për ta ndërgjegjësuar komunitetin rreth mbrojtjes së mjedisit.

Si gjimnaziste, filloi edhe bashkëpunimin në projekte të ndryshme me ushtarët amerikanë nga kampi ushtarak "Bondsteel" në Sojevë të Ferizajt. Dhe, ndërsa ndiqte kursin e avancuar të anglishtes në një shkollë gjuhësh, i ndihmonte mësuesit me nxënësit e rinj të gjuhës angleze dhe asaj gjermane…

Matura po afrohej, dhe në familje kishin zënë të shqetësoheshin që atë pak kohë të lirë që kishte Tina po e kalonte pranë kompjuterit. Por, prindërit e kuptonin dhe e mbështesnin vajzën e tyre, me të gjitha mundësitë. Ajo i kishte vënë vetes cak të studionte jashtë vendit dhe tashmë hulumtonte për orë të tëra për programe akademike dhe bursa.

Florentina kreu shkollën e mesme, në maj të vitit 2008 dhe me një anglishte të rrjedhshme dhe përkushtim të lartë ndaj punës, u paraqit sërish në Bondsteel. Këtë radhë kishte intervistë për një vend pune me orar të plotë. Kandidatët ishin të shumtë dhe me përvojë. Por, kompania "Kellogg, Brown & Root", e njohur si KBR, e zgjodhi 18-vjeçaren për pozitën e koordinatores në shërbim të udhëtarëve ushtarakë.

## Përkrahje e veçantë nga kompania prestigjioze "The Bislimi Group" dhe Faton Bislimi

Tina e donte punën në kampin ushtarak veçse s'i ndahej synimit për t'u arsimuar jashtë vendit. Atë verë ajo hasi në një mundësi të rrallë për studime në Shtetet e Bashkuara. Një i ri nga Kosova, që po ndiqte studimet pasdiplomike në Harvard, kishte bindur universitetin e tij amë, në Teksas, që të niste një program bursash për Kosovën. Kështu, Universiteti "Texas Lutheran" (TLU), me angazhimin e ish-studentit të dalluar Faton Bislimi, hapi dyert për dhjetëra kosovarë të tjerë që ta ndiqnin ëndrrën e tyre përmes programit "Arsimim për paqe"…

Ndër kandidatët e parë të përzgjedhur përmes një ecurie të rreptë, qe Florentina, e cila studio shkencat kompjuterike, me drejtim dytësor, matematikën dhe administrimin e biznesit. Ndonëse kishte zgjedhur fushat më sfiduese, ajo mori pjesë aktivisht në organizata studentore dhe diplomoi me sukses shembullor dhe lëvdatat më të larta (summa cum laude).

Me t'u diplomuar, në maj 2012, kompania "Rackspace", që ofron shërbime të hostimit në re (cloud hosting), e angazhoi Tinën si praktikante-analiste biznesi në zhvillimin e produkteve softuerike. Me zyrë në qytetin e bukur të San-Antonios, në Teksas, kosovarja e re punoi përkrah inxhinierëve të dalluar amerikanë, para se ta finalizonte angazhimin e radhës: punësimin që ia kishte ofruar që në pranverë firma konsulente me renome botërore "Pricewaterhouse Coopers (PwC)".

Kështu, në gusht 2012, Tina la San-Antonion për qytetin tjetër të madh të Teksasit. Në Dallas, ajo do të punonte si konsulente e forenzikës kompjuterike me PwC për tri vjetët e ardhshëm. E specializuar në reagimin, analizën dhe hetimin e incidenteve të sigurisë kibernetike, Florentina u shërbeu me sukses klientëve e korporatave të mirënjohura, për t'u bërë ballë sulmeve të hakerëve.

Tina punonte në Teksas, që ishte ndër dhjetë ekonomitë më të mëdha në botë. Por zemra e teknologjisë ndodhej disa milje drejt perëndimit, në Luginën e Silikonit, apo Silicon Valley - përgjatë Gjirit të San Franciskos së Kalifornisë, ku ndërmarrjet gjigante si "Facebook", "Apple" e "Google" u themeluan dhe po arrinin për ditë majat më të larta në veprimtarinë e tyre. Të tria këto kompani e intervistuan Florentinën dhe "Apple" e "Facebook" i ofruan pozita me kushte shumë atraktive. Tina zgjodhi "Facebook"-un.

Puna në ekipin e Sigurisë Kibernetike të "Facebook"-ut është me përgjegjësi të madhe, por edhe me shpërblim të madh.

Që nga qershori i vitit 2015 kompjuteristja kosovare ka zyrën në rrugën "Hacker Way", në Menlo Park të Kalifornisë, ku ndodhet selia e "Facebook"-ut.

Florentina përqendrohet në sigurinë kibernetike të kompanisë dhe ruajtjen e të dhënave, duke zbatuar njohuritë dhe përvojën e saj shumëvjeçare në forenzikën kompjuterike. Posaçërisht ajo merret me shqyrtimin e reagimit ndaj incidenteve të sigurisë kibernetike që ndodhin në "Facebook". Me mbi dy miliardë përdorues, rrjeti shoqëror, ka më së shumti të dhëna, për t'u mbrojtur nga të gjitha kompanitë. Puna në ekipin e sigurisë kibernetike të "Facebook"-ut bart përgjegjësi të madhe, por edhe shpërblim të madh, meqë ekipi përballet me sfida të reja dhe përherë sjell risi në industrinë e teknologjisë. Çdo problem që haset ndryshon nga të tjerët, duke kërkuar metodologji të ndryshme shqyrtimi e reagim të ri, për ta gjetur shkakun dhe zgjidhjen.

Këto janë detyrat e Florentinës, vajzës nga Pleshina e Ferizajt, e cila më 2008 ia mësyu Amerikës për t'i studiuar shkencat kompjuterike në Teksas dhe sot punon për gjigantin "Facebook" në Kaliforni. Në ndërkohë, ajo po synon studimet pasdiplomike për inovacion dhe ndërmarrësi në Universitetin Stanford, ndër më prestigjiozët në rruzull.

Florentina banon në qytetin Palo Alto, qytet përbri Menlo Parkut, ku ndodhet "Facebook"-u dhe Stanfordi, ku ngrihet universiteti, në rrethin e San-Franciskos. Jeton me të fejuarin Kemajl Qerimi, fotograf dhe biznesmen nga Ferizaj, dhe motrën Egzona Ferati, e cila, gjithashtu, është punësuar në "Facebook" nga viti i kaluar.

Tina ka pasion teknologjinë dhe inovacionin. Në të ardhmen synon të zhvillojë një biznes inovativ që përmirëson jetën e njerëzve. Ajo veçse ka filluar të punojë në atë drejtim. Në kohën e lirë udhëton duke eksploruar vende të reja e kultura të ndryshme në botë. Pëlqen leximin, fitnesin, vetëpërmirësimin dhe kohën me familje.



E rrallë

## Sheh djalin duke bërë detyrat në rrugë, vendos ta bëjë me shtëpi



Një djalë 12-vjeçar po i bënte detyrat poshtë dritës së llambës së rrugës, pasi mamaja e tij nuk kishte para për të paguar energji. Djali, që jeton në një qytet të Perusë, është me nota të shkëlqyera në shkollë dhe dëshiron të mësojë shumë, që të bëhet një polic i aftë kur të rritet dhe ta ndalojë korrupsionin në vend. Por një milioner 31-vjeçar nga Bahreni, Jakub Jusuf Ahmed Mubarak, i cili ishte udhëtuar në Peru, ka paguar që tani borxhin e energjisë elektrike, madje ka vendosur t'i rinovojë të gjithë shtëpinë.

FOTO E DITES



Një turmë e madhe e qytetarëve shihet duke kaluar në një kalim të këmbësorëve në Tokio. /AP/

E jashtëzakonshme

## Kirurgët heqin tumorin me një masë prej pesë kilogramë



Burri i cili njihet vetëm me emrin Sakthivel jeton në qytetin e Dindigulit, në Indi. Frika e tij më e madhe ishin ndërhyrjet kirurgjikale pasi vëllai i tij kishte vdekur në një sallë operacioni. Dhe e kishte të pamundur për t'i blerë ilaçet për trajtimin e sëmundjes së tij, pasi ishin të kushtueshme. Kirurgët ndërmorën një operacion që zgjati plot 10 orë, për të hequr nga koka e tij tumorin të një peshë prej pesë kilogramësh.

## BARSOLETA E DITËS



**Mysafiri futet në restorant dhe pyet kamerierin:**
**- O kamerier, a ka ujë?**
**Kamerieri ia kthen:**
**- Po zotëri, sa të duash.**
**Mysafiri i thotë:**
**- Ma sill një peshqir se po lahem.**

KINO ABC PRISHTINE

### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC



**Vetem gjate vikendit ne ora 14:00**

### "DUMBO" 3D

Fantazi/Familjar; 1 ore 52 min

**Rolet:** Colin Farrell, Michael Keaton, Danny DeVito, Eva Green, Alan Arkin, etj.
**Regjia:** Tim Burton



**Ne ora 16:00 dhe 19:00**

### "AVENGERS; Endgame"

Aksion/Aventurë/Fantazi; 3 ore 02 min

**Rolet:** Robert Downey Jr., Chris Evans, Mark Ruffalo, Chris Hemsworth, Scarlet Johansson, Don Cheadle, Bradley Cooper, Gwyneth Paltrow, Jeremy Renner, Josh Brolin, etj.
**Regjia:** Anthony Russo, Joe Russo

**Në ora 20:00**

### "EXTREMELY WICKED, SHOCKINGLY EVIL, AND VILE"



Krim/Mister; 1 ore 48 min

**Rolet:** Zac Efron, Lily Collins, Kaya Scodelario, Jeffrey Donovan, Angela Sarafyan, Dylan Baker, John Malkovich, etj.
**Regjia:** Joe Berlinger



**16.05.2019**

### "THE HUSTLE"

Komedi

Rolet: Anne Hathaway, Rebel Wilson, Alex Sharp, Dean Norris, etj.

Regjia: Chris Addison

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Ditë e lumtur për ju. Sot nuk do të zhgënjeheni nga ato çaste që do t'jua ofrojë dita.



**DEMI**
Jeni shumë krenar dhe ambicioz dhe nuk pranoni që edhe ju mund të gaboni. Kjo lloj sjelljeje do t'ju bëjë shumë dëm në komunikim.



**BINJAKËT**
Sot dita do të kalojë qetë dhe nuk do të keni ato debate që ju kanë shoqëruar kohët e fundit me partnerin.



**GAFORRJA**
Edhe pse sot në punë do të gjeni një ambient agresiv ju nuk do të ndikoheni. Jeni shumë të qartë në objektivat tuaja.



**LUANI**
Në punë ose me studime, sot keni vendosur që dita do të jetë me shumë aktivitete. Çdo gjë varet nga një përgjigje që do të jepni në fund të ditës.



**VIRGJËRESHA**
Seksi dhe dashuria më në fund po bashkohen për ju. Sot dita do të jetë shumë pasionante.



**PESHORJA**
Do të keni fat në lojë sot, por jo në dashuri. Një zënkë me partnerin do t'ju mërzisë dhe do të mbylleni në vetvete.



**AKREPI**
Sot do t'u tregoni eprorëve tuaj se sa të zotë jeni. Keni kaq kohë që dëshironi ta evidentoni punën tuaj dhe sot do të jetë dita.



**SHIGJETARI**
Dita do të kalojë në shoqëri të mirë dhe ju do të besoni te një mik një projekt të rëndësishëm.



**BRICJAPI**
Edhe pse keni pasur paragjykime karshi një personi, sot do të zhduken të gjitha. Bashkëpunimi juaj në të ardhmen do të jetë mjaft i ngushtë.



**UJORI**
Po merreni qetësisht me interesat tuaja sot dhe çdo gjë tjetër ka kaluar në plan të dytë. Pasditja paraqitet e qetë.



**PESHQIT**
Nëse keni orga-nizuar një festë ose një takim intere-sant sot, do të dilni shumë të kënaqur. Ju do të jeni në qendër të vëmendjes.

# Rita Ora shpreh ndjenjat e saj të vërteta për Liam Payne




Që kur është bërë pjesë e skenës muzikore, Rita Ora është supozuar se ka qenë e lidhur me disa meshkuj të njohur në mbarë botën siç janë Bruno Mars, Rob Kardashian dhe Asap Rocky të cilët kanë deklaruar se kanë qenë të dashuruar me këngëtaren me origjinë shqiptare. Lidhjet e saj zyrtare kanë qenë me Calvin Harris, Andrew Wyatt dhe Ricky Hilifiger. Së fundmi e kemi parë këngëtaren shpesh së bashku me Liam Payne dhe janë ngritur hipoteza se ata mund të jenë në një lidhje së bashku. Por Rita Ora ka hedhur poshtë këto hipoteza duke thënë se ajo dhe Liam janë thjesht miq dhe asgjë më tepër se kaq.

# Moderatorja i jep fund beqarisë



Ylli televiziv britanik Katie Price është gati për t'u martuar me të dashurin 11 vjet më të vogël. Unaza me diamant që mbante në dasmën e shoqes nxiti spekulimet se është fejuar me Kris Boyson. Moderatorja 41-vjeçare dhe Kris, 31 vjeç, ishin pjesë e të ftuarve duke treguar se e kanë harruar zënkën që pati në fillim të këtij muaji. Katie dhe Kris shijojnë lidhjen e dashurisë prej një viti. Ata u njohën në maj të vitit 2018 dhe kanë pasur disa zënka gjatë kësaj periudhe, por kjo nuk i ndalon që ta kurorëzojnë dashurinë me martesë.



# Halle Berry, fotografi e nxehtë me bikini

Dy duart në bark dhe bikini në pamje të thjeshtë. Halle Berry vë në lojë ndjekësit në "Instagram" me një foto të nxehtë. Në realitet kjo është një çështje marketingu, sepse aktorja amerikane e bën atë për të promovuar një linjë kostumesh që ajo ka nënshkruar së fundmi, por në mediat sociale ndjekësit vlerësojnë fotografinë me komente të shumta. Me pak fjalë, postimi u promovua. Si formë fizike, e pa të meta.

# Cardi B i blen byzylyk me vlerë 80 mijë dollarë vajzës dhjetëmuajshe



Cardi B ka një pasuri me vlerë 8 milionë dollarë. Ajo nuk kursen fare kur bëhet fjalë për vajzën e saj dhjetëmuajshe, Kulture. Reperja i bleu Kulturës një byzylyk me diamante me vlerë 80 000 dollarë. Cardi publikoi fotografinë me bizhuterinë në dorën e vajzës në rrjetet sociale, por e fshiu shumë shpejt. Ajo u martua me bashkëshortin Offset rreth një vit më parë dhe janë prindër të Kulturës.




# Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"

TEL: 045 82 82 82

# Selimi: Jam nismëtar i sukseseve te Feronikelit

Musa Selimi për "Epokën e re" ka thënë se ai është nismëtar i sukseseve të Feronikelit në futbollin e Kosovës. Trajneri gjilanas e ka drejtuar skuadrën nga Drenasi në edicionin 2011/2012, kur kjo skuadër e siguroi inkuadrimin në Superligë. Aktualisht "Nikli" është ndër skuadrat më të trofeshme në futbollin e Kosovës, kurse sivjet do të marrë pjesë në garën e Ligës së Kampionëve



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

Prishtinë, 28 maj - KF Feronikeli, pas triumfit në kampionat dhe kupë, ka hyrë në mesin e tri klubeve më të trofeshme në futbollin e Kosovës. Rezultatet dhe organizimi i mirëfilltë i kësaj skuadre filloi në vitin 2011/2012, kur edhe u inkuadrua në Superligën e Kosovës, për çka merita të mëdha ka trajneri i atëhershëm, Musa Selimi. I kontaktuar nga redaksia e sportit e gazetës "Epoka e re", Musa Selimi kujton kohën kur e mori drejtimi e këtij klubi, i cili për pak vite do të shndërrohej ndër më të mirët në vend. "Më kujtohet shumë mirë koha kur e kam marrë drejtimin e Feronikelit në vitin 2011, pra aty filloi një revolucion në këtë klub me mbështetje nga Komuna e Drenasit dhe donatorët e ndryshëm. Si trajner i kësaj skuadre jam munduar me përkushtim ta bëj punën time edhe jashtë asaj që i përket një trajneri dhe në edicionin 2011/2012 kemi qenë në vend të parë nga fillimi e gjerë në fund ku edhe siguruam inkuadrimin në Superligë. Po ashtu, gjatë kësaj kohe kemi punuar shumë edhe në organizim të klubit, ku kemi themeluar edhe tifozët 'Tigrat e Zi'", ka thënë Selimi, i cili krenohet për sukseset që po arrin skuadra nga Drenasi në futbollin e Kosovës.

Madje "Profa" beson se "Nikli" do të ketë suksese edhe në arenën ndërkombëtare. "Sukseset e skuadrës dhe organizmi ka shkuar çdo vit duke u përmirësuar, por bazamenti i një klubi profesional është bërë në kohën kur unë isha trajner. Jam krenar për sukseset që ka arritur ky klub dhe besoj se këto nuk do të mungojnë edhe në vitet në vazhdim. Pres që Feronikeli të ketë paraqitje dinjitoze në garat parakualifikuese të Ligës së Kampionëve", ka shtuar Selimi.

Trajneri gjilanas që aktualisht është dekan në Fakultetin e Kulturës Fizike dhe Sportit, e vlerëson kohë e kaluar në skuadrën e "Niklit" si ndër më të mirët në karrierën e tij si trajner. "Koha sa isha pjesë e Feronikelit është ndër kujtimet e mia më të mira, pa harruar edhe kohën kur me Gjilanin e kam fituar Kupën dhe Superkupën", ka përfunduar Selimi.

## Çiftet e barazhit: Bashkimi - Dardana dhe Ramiz Sadiku - Rahoveci

Bashkimi (K) - Dardana dhe Ramiz Sadiku - Rahoveci janë çiftet e barazhit për Ligën e Parë që i përcaktoi shorti i hedhur të martën në Federatën e Futbollit të Kosovës. Më 2 qershor zhvillohet ndeshja në mes të Bashkimit dhe Dardanës, kurse një ditë më vonë zhvillohet ndeshja në mes të Ramiz Sadikut dhe Rahovecit. Të dyja këto ndeshje zhvillohen në stadiumin "Riza Lushta" në Mitrovicë.

# Hadërgjonaj: Mezi pres ta luaj ndeshjen e parë për Kosovën

Prishtinë, 28 maj - Florent Hadërgjonaj është prej futbollistëve të parë që ka mbërritur në Kosovë për t'i nisur përgatitjet për dy ndeshjet kualifikuese të Evropianit 2020 kundër Malit të Zi dhe Bullgarisë. Hadërgjonaj deri tash kishte përfaqësuar Zvicrën në ekipet e grupmoshave, por edhe Kombëtaren A në një ndeshje miqësore, javë më parë vendosi t'u bashkohej "dardanëve". "Falënderoj të gjithë në FFK, e sidomos presidentin Agim Ademi dhe trajnerin Bernard Challandes, sepse ata kanë qenë dy njerëzit kryesorë me të cilët kam biseduar në muajt e fundit dhe pas bisedave shumë të mira erdhi momenti që unë të vij të luaj për Kosovën", ka thënë Hadërgjonaj.



Ndonëse ishte pjesë e Zvicrës, futbollisti thotë se vazhdimisht e ka ndjekur zhvillimin e Përfaqësueses së Kosovës dhe është emocionuar me paraqitjet e tashmë bashkëlojtarëve të tij. "I kam shikuar pothuajse të gjitha ndeshjet e Kosovës si në kualifikime, po ashtu edhe në Ligën e Kombeve nëpërmjet TV-së në Angli dhe kam qenë i mahnitur me atë çfarë ka treguar ekipi. Loja e përfaqësueses, por edhe mbështetja që i kanë dhënë tifozët, ka qenë diçka shumë e veçantë. Çunat e bënin lojën shumë të mirë. Ka lojtarë shumë të talentuar dhe tani jam edhe unë pjesë e grupit dhe qëllimi im është ta ndihmoj ekipin të ecë përpara. Kryesorja është që hap pas hapi të bëhemi edhe më të fortë. E di që ka ende punë sepse jemi lojtarë të rinj dhe kemi ende gjëra për të mësuar, por besoj se mund të arrijmë diçka shumë të madhe", ka shtuar Hadërgjonaj.

Anëtari i deritashëm i Huddersfieldit është i vetëdijshëm se në ekipin përfaqësues ka shumë talentë dhe konkurrenca është e madhe, por këtë e vlerëson si diçka pozitive. "Gjithkund ekziston konkurrenca si në klub ashtu edhe në ekipin kombëtar. Ekipi nuk i ka vetëm 11 lojtarë, por konkurrenca duhet shikuar në aspektin pozitiv sepse mund t'i ndihmojmë njëritjetrit. Pastaj është trajneri që vendos për lojtarët që do të luajnë. Neve si futbollistë na mbetet që ta japim maksimumin në stërvitje në mënyrë që ta shoh trajneri se je i gatshëm dhe i rëndësishëm për kombëtaren", ka shtuar Hadergjonaj. "Gjithmonë e kam vizituar Kosovën sepse është vendlindja e prindërve të mi dhe ende i kam disa familjarë këtu. Për mua Kosova gjithmonë ka qenë e rëndësishme. Prindërit shpesh na sillnin këtu në mënyrë që mos ta harrojmë gjuhën, sepse kur jeton në Zvicër dhe shkollohesh atje nuk është aq lehtë të mos e harrosh gjuhën. Për mua Kosova është gjithçka. Këtu ndihem më i lirë dhe më i lehtësuar sepse të gjithë flasin shqip. Edhe në ekipin kombëtar do t'i kem të gjithë bashkëlojtarët që flasin shqip. Kur nuk ke nevojë të flasësh në gjuhë tjetër kjo të ndihmon dhe është shumë motivuese. Fanella e Kosovës për mua është diçka shumë e veçantë, prandaj me padurim pres ta luaj ndeshjen e parë, e cila do të jetë shumë emocionuese si për mua, po ashtu edhe për familjen time", ka deklaruar Hadërgjonaj.

# Vashat e Istogut shpërblehen me 10 mijë euro

Prishtinë, 28 maj - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka pritur sot në takim hendbollistet e Klubit Istogu dhe trajnerin e tyre Faruk Shala, pas sukseseve që hendbollistet kanë arritur ta fitojnë titullin e kampionit si dhe kanë fituar Kupën e Kosovës.

Trajneri Shala ka thënë se ndihet krenar me suksesin e hendbollisteve. Ai e njoftoi në hollësi ministrin për suksesin e arritur, ku në edicionin 2018/2019 KHF Istogu ishte pjesë e 16 skuadrave më të mira të Evropës në kuadër të kupës "EHF Challenge Cup", duke u konfirmuar si një prej klubeve më të mira në rajon. Ministri Gashi ka thënë se suksesеve në sport u gëzohemi të gjithë, aq më tepër kur gjeneratat e reja korrin suksese. Ky fakt jep shpresë për të punuar dhe për t'u angazhuar edhe më shumë drejt arritjeve të reja. "E mirëpres suksesin e femrave të Klubit të Hendbollit Istogu. Prezantimi dhe fitoret e hendbollisteve brenda dhe në garat jashtë vendit meriton të shpërblehet. Duke qenë se KHF Istogu ka arritur të shpallet kampion dhe ta fitojë Kupën e Kosovës në hendboll, kemi marrë vendim që ta shpërblejmë me 10 mijë euro", ka thënë Gashi.



## Refuzohet ankesa e Trepçës '89, Drita i shpëton barazhit



PRISHTINË, 28 MAJ - Komisioni i Garave i IPKO Superligës mori vendim që të refuzohet kërkesa e skuadrës së Trepçës '89 për ndeshjen në mes të Dritës dhe Flamurtarit. Sipas vendimit, kjo ndeshje regjistrohet me rezultatin e arritur në fushë 1-2 për skuadrën nga Prishtina. "Komisioni i Garave konstatoi se ankesa e KF Trepça '89 është e paafatshme dhe nuk i përmbush kushtet e përcaktuara në nenin 71, paragrafin 2 të Rregullores së Garave. Kur xhirot zhvillohen të dielën dhe të mërkurën, atëherë kompletimi i lëndës së ankesës dhe taksimi i saj duhet të bëhet brenda 24 orëve nga përfundimi i ndeshjes së zhvilluar. Nëse afati për ushtrimin e ankesës skadon në ditën e diel ose në ditën e festave shtetërore, afati për ushtrimin e ankesës vazhdon edhe në ditën e parë të ardhshme të punës. Në rastin konkret ndeshja është zhvilluar ditën e mërkurë, më datë 15.05.2019, derisa ankesa është ushtruar më 16.05.2019, kurse taksimi-pagesa është bërë më 17.05.2019", thuhet në vendimin e Komisionit të Garave.

# Reja: Objektivi ynë është kualifikimi në 'Euro 2020'



LISTA E FUTBOLLISTËVE

Portierë: Berisha, Hoxha dhe Selmani.
Mbrojtës: Aliji, Hysaj, Ismajli, Ajeti, Kumbulla, Balliu, Veseli, Mihaj, Binaku, Dermaku, Mavraj.
Mesfushorë: Abrashi, Basha, Memushaj, Kaçe, Ndoji, Qose, Xhaka, Ramadani, Lenjani.
Sulmues: Uzuni, Balaj, Cikalleshi, Sadiku, Grezda, Roshi.

TIRANË, 28 MAJ - Kombëtarja e Shqipërisë në futboll nisi grumbullimin zyrtar për ndeshjet kualifikuese të "Euro 2020" ndaj Islandës dhe Moldavisë. Trajneri Edy Reja publikoi listën e të grumbulluarve, ku bie në sy mungesa e Strakoshës, rikthimi i Mavrajt e Cikalleshit dhe thirrja për herë të parë e Kumbullës.
Trajneri italian pranoi se për këto dy sfida do të bazohet te grupi aktual i skuadrës. "Kam një listë me 35 lojtarë, por për këto dy ndeshje kam bërë këtë zgjedhje, duke marrë futbollistë që kanë qenë më parë dhe që e njohin njëri-tjetrin. Për momentin do të bazohemi te këta lojtarë. Objektivin e dimë të gjithë: kualifikimi për në 'Euro 2020'. Në garë janë 5 skuadra, por vetëm dy do të kualifikohen. Përveç Francës, që është një skuadër potente, me ekipet e tjera kemi mundësi për të fituar. Kush vjen këtu duhet të jetë i bindur për arritjen e objektivit dhe në fund do t'i bëjmë llogaritë", ka thënë Edoardo Reja, trajner i Kombëtares kuqezi.
Javën e kaluar Reja organizoi një grumbullim paraprak ku kishte përfshirë dhe lojtarë të U21-shit. "Puna që bëmë javën e kaluar ishte për t'i mbajtur futbollistët në formë. Falënderoj Partizanin për lojtarët që vuri në dispozicion. Pastaj vëzhgova edhe lojtarët e U21-shit që sapo u kthyen. Por, stërvitja e parë e vërtetë është sot. Skuadra ka nevojë për ekuilibër, pasi ka mangësi në këtë aspekt. Shpresoj të jap ndihmën time, por varet nga bashkëpunimi me lojtarët. Nëse lojtarët besojnë tek ajo që propozoj dhe bashkëpunojnë, atëherë jemi në avantazh në krahasim me problemet e së kaluarës", ka shtuar Reja. Edy Reja theksoi se do të kërkojë që ta vijojë punën e De Biasit, ndërkohë që për Christian Panuccin theksoi se ishte i pafat. Ai shtoi se do të bëjë menaxhim demokratik të grupit, por kjo nuk do të thotë se nuk do të ketë kritika ndaj lojtarëve, ndërkohë që e mbylli konferencën për shtyp me një incident.

# Sonte finalja Chelsea - Arsenal




Baku, 28 maj - Dy skuadrat rivale në Premierë Ligë, Chelsea dhe Arsenal, përballen sonte (e mërkurë) në finale të Evropa Ligës në Stadiumin Olimpik të Bakusë në Azerbajxhan nga ora 21:00. Kjo është vetëm finalja e dytë angleze në garën e dytë për nga rëndësia që e organizon UEFA. Një e tillë kishte ndodhur në vitin 1972 kur ishin takuar Tottenham Hotspur dhe Wolverhampton Wanderers.
Vendi i pestë në Premierë Ligë për Arsenalin do të thotë se trajneri Unai Emery mund të vlerësohet i suksesshëm vetëm nëse do të triumfojë në këtë garë që do t'ia siguronte edhe një vend në Ligën e Kampionëve, ndërsa në anën tjetër trajneri i Chelseat, Maurizio Sarri, ka qenë nën presion gjatë gjithë sezonit për të bërë Chelsean një skuadër fituese dhe tash e ka rastin që të përfundojë këtë mision. Chelsea ka pësuar një goditje para kësaj ndeshje, pasi N'Golo Kante është lënduar dhe mund të mungojë në finale. Loftus-Cheek, Hudson-Odoi dhe Antonio Rudiger janë mungesat e tjera në formacionin e Sarrit. Derisa në sulm trajneri italian preferon Giroudin para Higuainit, në anën tjetër Unay Emery nuk mund të llogarisë në mesfushorin Henrikh Mkhitaryan, i cili nuk udhëton në Azerbajxhan për arsye politike. Aaron Ramsey mungon për shkak të lëndimit, kurse mungesa të tjera janë edhe Hector Bellerin, Rob Holding dhe Denis Suarez. Sulmuesi që shumicën e kohës ishte i lënduar, Danny Welbeck, është gati për këtë ndeshje.

FORMACIONET E MUNDSHME:

Chelsea (4-3-3): Kepa, Azpilicueta, Christensen, Luiz, Emerson, Kovaqiq, Jorginho, Barkley, Pedro, Giroud, Hazard.
Arsenali (3-4-1-2): Cech, Sokratis, Koscielny, Monreal, Maitland-Niles, Torreira, Xhaka, Kolasinaq, Ozil, Aubameyang, Lacazette.

SHKURT

## Brazili ia heq shiritin Neymarit, kapiten i ri Dani Alves

Brazili po përgatitet për "Copa America", e cila starton më 14 qershor, teksa prej disa ditësh trajneri Tite ka zyrtarizuar listën e të grumbulluarve. Trajneri Tite ka vendosur se Neymari nuk do të jetë më kapiten i Kombëtares së Brazilit. Ky vendim duket se ka ardhur pas incidenteve të ndodhura në finalen e Kupës ndaj Rennes, ku Neymari u kap me një nga tifozët kundërshtar. Kapiten i ri i Brazilit do të jetë Dani Alves, i cili do ta marrë shiritin që në sfidat miqësore në kuadër të "Copa America" dhe më pas gjatë gjithë kompeticionit. Ende nuk ka pasur një reagim nga Neymari, por duket se te Brazili ka shpërthyer një çështje.

## Joshua: Nuk e kuptoj ç'po bën Wilderi

